



Instrumenti për Përafrim me Acquis të BE-së

Mbështetje e mëtejme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

Nr. identifikues i projektit:

EuropeAid/138565/DH/SER/XK

Kontrata e Shërbimit Nr. 2018/395-320

**Raporti mbi BJT që prekin eksportuesit Kosovarë
Draft dokument për diskutim**

Prill 2019



Personat kontaktues brenda
GFA Consulting Group GmbH janë

Znj. Martina Bernauer (Drejtore e Projektit)
Z. Luis Abugattas (Udhëheqës i ekipit)

Kosovë

Mbështetje e mëtejme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

Numri i kontratës 2018/395-320

Akt 3.1.3 - Raporti mbi BJT që prekin eksportuesit kosovarë

-

Autor

Z. Naim Huruglica

Znj. Anita Sutaj

Znj. Merita Fetahu

Mohim

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe GFA Consulting Group GmbH dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë për të pasqyruar pikëpamjet e Bashkimit Evropian

Për BE: Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-s mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës

GFA Consulting Group GmbH

Eulenkrogstr. 82
D-22359 Hamburg
Gjermani

Telefoni: +49 (40) 6 03 06 170

Fax-i: +49 (40) 6 03 06 159

ii

E-mail: martina.bernauer@gfa-group.de

Përmbajtja

1	Përmbledhje analitike	1
2	Eksportet e Kosovës ne vendet e CEFTA-së	5
3	Metodologjia	7
4	Rezultatet nga hulumtimi	9
4.1	Pengesat dhe barrierat për të eksportuar në vendet e CEFTA-së	11
4.1.1	Eksportimi në Serbi	11
4.1.2	Eksportimi në Bosnjë dhe Hercegovinë	11
4.1.3	Pengesat për të eksportuar në Shqipëri	12
4.1.4	Pengesat për të eksportuar në Serbi	12
4.1.5	Pengesat për të eksportuar në Maqedoninë Veriore	13
4.1.6	Pengesat për të eksportuar në Mal të Zi	13
4.1.7	Pengesat për të eksportuar në Bosnjë dhe Hercegovinë	13
4.2	Pengesat dhe procedurat e brendshme në Kosovë që ndikojnë në eksport.....	15
5	Të gjeturat	17
6	Rekomandimet	19
7	Shtojca 1 Pyetësori	20
8	Shtojca 2 Lista e Kompanive që kanë marrë pjesë në hulumtim	22
9	Shtojca 3 Eksportet kryesore në vendet e CEFTA-së.....	23

Lista e Tabelave

Tabela 1: Klasifikimi i Masave Jo-Tarifore.....	3
Tabela 2: Eksportet e mallrave në CEFTA, 2015-2018.....	5
Tabela 3: Produktet më të eksportuara nga Kosova në CEFTA në 2018	6
Tabela 4: Kompanitë eksportuese në vendet e CEFTA-së në 2018	7
Tabela 5: Shpërndarja e mostrës sipas sektorit të aktivitetit ekonomik	8
Tabela 6: Eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA-së në 2018	9
Tabela 7: Pjesëmarrja e eksporteve nga qarkullimi i tyre i përgjithshëm dhe i eksporteve në CEFTA nga totali i eksporteve të tyre.....	9
Tabela 8: Opinionet e të anketuarve në lidhje me lehtësinë e eksportimit në vendet e CEFTA-së	10

1 Përmbledhje analitike

Objektivi i përgjithshëm

Të kontribuohet në përpjekjet që po ndërmerren për të adresuar efektet çrregulluese tregtare të BJT-ve, që ndikojnë në tregtinë e Kosovës me vendet e tjera anëtare të CEFTA-s.

Objektivi specifik

Qëllimi specifik i këtij hulumtimi është të identifikohen dhe të shqyrtohen BJT-të më të përhapura që prekin eksportuesit e Kosovës në secilin prej vendeve anëtare të CEFTA-s dhe të ofrohen rekomandime për mënyrat dhe mjetet për të zvogëluar ndikimin e tyre negativ në tregti.

Hyrje

Çështja e pengesave të pajustificueshme në tregti ndërmjet anëtarëve të vendeve të CEFTA-s është një temë e përsëritur në takimet zyrtare të CEFTA-s dhe burim i fërkimeve dhe ankesave të vazhdueshme të tregtarëve, si eksportuesve, ashtu edhe importuesve. Shumë studime kanë treguar se tregtia ndër-rajonale është mjaft nën potencial dhe një gjendje e tillë, në kontekstin pa tarifa, pjesërisht i atribuohet ekzistencës së pengesave të pajustificueshme në tregti. Kjo gjendje vazhdon edhe përkundër faktit se CEFTA përfshin dispozitat për heqje të barrierave jo-tarifore (BJT-t) dhe se kjo detyrë bie në kuadër të mandatit të strukturave institucionale të krijuara në kuadër të CEFTA-s: Nën-Komiteti i Barrierave Teknike të Tregtisë (BTT-t) dhe BJT-t, Nën-Komiteti për bujqësi dhe çështjet e sanitarisë dhe fito-sanitarisë (SFS), dhe Nën-komiteti i doganës dhe rregullave të origjinës. Përveç kësaj, objektivi kryesor në këtë fushë që duhet të arrihet përmes Plan-Veprimi të Konsoliduar Shumëvjeçar për Zonën Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor 6th (MAP) është krijimi i rajonit dhe MJT-t pa TDM.¹

Ky raport jep vlerësimin e pengesave me të cilat eksportuesit kosovarë ballafaqohen gjatë eksportimit në vendet e tjera të CEFTA-s. Për një ekonomi të vogël të hapur sikur kjo e Kosovës, rritja e eksporteve është e një rëndësie kapitale. Tregjet e CEFTA-s janë destinacioni kryesor i eksporteve të Kosovës, prandaj çdo pengesë me të cilën eksportuesit ballafaqohen për qasje në ato tregje ka implikime domethënëse në rritje dhe zhvillim. Në lidhje me këtë, adresimi i pengesave të pajustificueshme ndaj tregtisë është lartë në agjendën e Qeverisë. Siç tregon ky raport, Kosova nuk ka qenë në gjendje të korrë të gjitha përfitimet e pritshme nga tregtia në pjesëmarrjen e saj në Marrëveshjen e CEFTA-s, veçanërisht në krahasim me performancën e anëtarëve të tjerë të grupimit rajonal. Kosova ka pësuar një deficit strukturor në rritje në tregtinë e saj rajonale, duke u bërë destinacioni kryesor i importit për eksportet e anëtarëve të tjerë të CEFTA-s.

Objektivi kryesor i këtij aktiviteti ishte vlerësimi i shkallës në të cilën eksportuesit kosovarë ndeshen me pengesa gjatë eksportimit në CEFTA dhe identifikimi i pengesave specifike që prekin ato. Vlerësimi i kryer përmes intervistave me 50 kompani në Kosovë ka identifikuar një numër të konsiderueshëm vështirësish dhe pengesash me të cilat kompanitë kosovare ballafaqohen gjatë eksportimit në vendet anëtare të CEFTA-s. Përveç pengesave për t'u pranuar në tregjet e eksportit, kompanitë kanë raportuar një numër të madh vështirësish me të cilat ballafaqohen brenda Kosovës për shkak të procedurave burokratike të aplikuara nga autoritetet e Kosovës dhe vështirësive të tjera që rezultojnë nga mjedisi i papërshtatshëm

¹ Në fushën e politikave tregtare MAP-i parashikon që "Sekretirati i CEFTA-s do të vazhdojë monitorimin e Masave Jo-tarifore (MJT-t) në rajon; për ta bërë këtë, çdo vit do të përgatitet një raport mbi pengesat kryesore në tregti. Raporti në veçanti do të pasqyrojë pengesat aktuale me të cilat përballen kompanitë dhe shkejlet e kushteve të barazive që duhet të mbizotërojnë për kompanitë në rajon. Palët e CEFTA-s e njohin rolin e rëndësishëm të sektorit privat në sistemin e monitorimit të MJT-ve në tregtinë e mallrave dhe barrierave në tregtinë e shërbimeve, ku Forumi i Investimeve të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor (FIOBP) do të kontribuojë në strukturë". Duhet theksuar se qëllimi është krijimi i një rajoni të lire nga MJT-ve; nënkupton për dorim të papërshtatshëm të termave, keqkuptimi i dallimit në mjetet MJT-ve dhe BJT-ve.

afarist në vend, siç është mungesa e stafit brenda autoriteteve të Kosovës që janë përgjegjës për procedurat e eksportit, burokracitë e panevojshme dhe kostot e tepërta.

Në këtë drejtim, për shembull një studim i Bankës Botërore zbuloi se një eksportuesi kosovar i nevojiten gati dy ditë (42 orë) për procedurat kufitare dhe një tjetri 1.5 ditë (38 orë) për procedurat dokumentare, në krahasim me mesataren e 7 orëve dhe 3.8 orëve në pesë shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, firma kosovare do të duhet të paguajë 264 US\$ për eksport, krahasuar me një mesatare prej 72 US\$ në pesë shtetet e tjera.²

Eksportuesit e Kosovës po përballen me pengesa të natyrave të ndryshme kur eksportojnë në tregjet e CEFTA-s. Ekzistojnë dy lloje kryesore të pengesave: ato që dalin nga rrethanat politike që lidhen me mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës nga tre anëtarë të CEFTA-s: Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia; dhe pengesat procedurale të natyrave të ndryshme të cilat zbatohen nga të gjithë anëtarët e CEFTA-s. E para përbën një pengesë që është pothuajse e pamundur të kapërcehet, duke qenë e barabartë me një ndalim importi në tregjet e synuara. Pengesat dalin nga pamundësia për të udhëtuar me dokumentet personale të lëshuara nga Autoritetet e Kosovës dhe me automjetet e regjistruara të Kosovës, dhe mosnjohjen e certifikatave dhe dokumenteve të tjera të lëshuara nga Autoritetet e Kosovës. Pengesat procedurale dalin, ndër të tjera për shkak të zbatimit të testeve fitosanitare dhe / ose veterinarë për çdo eksport, mungesës së transparencës dhe burokracisë në kufi. Raporti identifikon problemet specifike që hasen në vendet e ndryshme të CEFTA-s. Në pjesën e fundit, ky raport paraqet disa rekomandime të politikave për të adresuar pengesat e ndryshme që prekin eksportuesit kosovarë.

Ky raport është strukturuar si më poshtë. Pjesa e radhës paraqet një shtjellim të shkurtër mbi natyrën e masave jo-tarifore dhe dallimin që duhet të bëhet me pengesat e pajustificueshme për tregtinë, dallim që nganjëherë është i papërfillshëm. Pjesa e tretë shqyrton shkurtimisht tregtinë e Kosovës me vendet anëtare të CEFTA-s, e cila ofron njohuri mbi efektet e mundshme të pengesave me të cilat po ballafaqohet Kosova gjatë tregtimit me vendet anëtare të CEFTA-s. Pjesa e katërt paraqet metodologjinë e përdorur për kryerjen e vlerësimit. Pjesa e pestë paraqet rezultatet e hulumtimit, ku identifikohen pengesat në secilin vend të CEFTA-s, ndërsa Pjesa e gjashtë përmbledhë gjetjet kryesore. Pjesa e fundit sugjeron disa rekomandime të politikave.

Barrierat jotarifore dhe pengesat e pajustificueshme në tregti: Dallimi i domosdoshëm

MJT-të përkufizohen si një koncept negativ, i cili përfshin fushën e të gjitha masave që dallohen nga tarifat e importit, por që mund të kenë ndikim në tregtinë ndërkombëtare. Sipas përkufizimit të pranuar ndërkombëtarisht, MJT-të janë "të gjitha masat e politikës përveç tarifave të zakonshme doganore që potencialisht mund të kenë një efekt ekonomik në tregtinë ndërkombëtare të mallrave, duke ndryshuar sasi të tregtuara, çmimet ose të dyja".³ Masat jo tarifore dhe në veçanti barrierat teknike në tregti, shpesh janë instrumentet më të mira për të arritur objektivat e politikave publike.

Masat jo-tarifore nuk duhet të jenë barriera jo-tarifore. Në adresimin e çështjes së pengesave në tregti është e rëndësishme që të bëhet qartë dallimi në mes të "masave jo tarifore" (MJT) dhe "pengesave të pajustificueshme në tregti" që mund të shënohen si BJT-t, dallim i rëndësishëm i cili ndonjëherë shpërfilllet, si në rastin e objektivave të përcaktuara për PSHV (MAP-in), një zone të lirë nga MJT-të, dhe në termat e referencës për Nën-Komitetin e CEFTA-s për BTT-të dhe BJT-të, e cila në mënyrë specifike përcakton që "detyra e Nën-komitetit është identifikimi, shqyrtimi dhe propozimi i masave për heqjen e barrierave teknike ndaj tregtisë dhe barrierave jo-tarifore ndërmjet Palëve ". Në kontekst të sovranitetit rregullator dhe

² Banka Botërore (2017) BALLKANI PERENDIMOR: Dokumentet për Çështjet e Integritimit Ekonomik Rajonal

³ UNCTAD/DITC/TAB/2009/3. Ky përkufizim nënkupton se grupi i MJT-ve është shumë i ndryshëm në kuptim të qëllimit, duke përfshirë masat që ndjekin një grup mjaft të diferencuar të qëllimeve të politikave publike; në aspektin e llojit të politikës, qoftë çmim, sasi ose masë rregullatore; dhe, në kushtet kur veprimi kryhet, nëse masa zbatohet në kufi, ose pas kufirit. MJT-te gjithashtu ndryshojnë në aspektin e formës së tyre ligjore dhe në aspektin e efektit të tyre ekonomik. Prandaj, duhet të theksohet se MJT-te të paktën dallojnë aq nga njëra tjetra, sa që bashkërisht dallojnë nga tarifa.

preferencave të ndryshme kombëtare, nuk është e përshtatshme që të synohet heqja e MJT-ve që ndjekin objektiva të rëndësishme rregullatore vendase. Përkundrazi, theksi duhet të jetë në zvogëlimin e kostove shpesh të paqëllimshme dhe çdo diskriminim të nënkuptuar ndërmjet furnizuesve vendas dhe të huaj.

Organizata të shumta ndërkombëtare që punojnë së bashku kanë përpunuar një klasifikim të detajuar të MJT-ve, i cili më së shpeshti përdoret sot si nga politikë bërësit, ashtu edhe nga hulumtuesit.⁴ Ky klasifikim përfshin 16 kapituj (A deri P), dhe çdo kapitull i veçantë është i ndarë në grupe deri në tre nivele. Klasifikimi aktual i MJT-ve paraqitet si versioni i vitit 2012.⁵ Ekzistojnë tri lloje të MJT-ve: teknike, jo-teknike dhe ato që ndikojnë në eksporte. Shtojca e këtij raporti paraqet në formatin tabelar klasifikimin ndërkombëtar të

IMPORTET	Masat Teknike	A Masat sanitare dhe jo-sanitare	7	31	4
		B Barrierat teknike në tregti	8	18	4
IMPORTET	Masat Jo- teknike	C Inspektimi para transportimit dhe formalitetet tjera	5		
		D Masat mbrojtëse tregtare kontigjente	3	9	6
		E Licencimi joautomatik, kuota, ndalesat dhe masat e kontrollit sasior dhe të tjera nga ato për SFS ose BTT	6	11	30
		F Masat e kontrollit të çmimit, përfshirë taksa dhe ngarkesa shtesë	9	19	
		G Masat financiare	5	9	3
		H Masat që ndikojnë në konkurrencë	3	5	
		I Masat për investime të lidhura me tregti	3		
		J Kufizimet në shpërndarje	2		
		K Kufizimet në shërbimet e pas-shitjes			
		L Subvencionet (përfshirë subvencionet e eksportit)			
		M Kufizimet qeveritare në prokurim			
		N Pronësia intelektuale			
		O Rregullat e origjinës			
EKSPORTET	EKSPORTET	Masat e lidhura me eksport	9	10	

MJT-ve. Tabela 1 paraqet taksonominë e MJT-ve.

Tabela 1: Taksonomia e Masave Jo-Tarifore

⁴ Klasifikimi i BJT-ve është diskutuar dhe propozuar nga organizatat e mëposhtme: Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara; FMN, Qendra Tregtare Ndërkombëtare; OECD; UNCTAD; UNIDO; Banka Botërore; dhe, OBT.

⁵ UNCTAD(2015). Klasifikimi Ndërkombëtar i Masave Jo Tarifore, Versioni i vitit 2012. UNCTAD / DITC / TAB / 2012 / 2Rev.1. Kombet e Bashkuara, Nju Jork dhe Gjenevë.

Duhet të theksohen tri çështje në lidhje me MJT-t. Së pari, ato ndjekin objektiva legjitime të politikave që merren me dështimin e tregut, që shfaqen nga informacioni asimetrik dhe eksternalitetet, si dhe objektivat e tjera jo-ekonomike të politikës publike. Prandaj, në vijim të përkufizimit ndërkombëtar të MJT-ve kërkesa për heqjen e tyre nuk është aspak e përshtatshme. Në këtë fushë objektivi do të duhej të ishte përmirësimi i rregulloreve, me qëllim të minimizimit të kostove të tyre për sektorin privat. Duke pasur parasysh këtë objektiv, problemet e përfshira në bërjen e MJT-ve me më pak efekt negativ në tregti, janë në thelb probleme të rregulloreve më të mira, të cilat janë të ngjashme me ato që hasen në përmirësimin e rregulloreve vendore. Së dyti, aplikimi i BJT-ve është i rregulluar ndërkombëtarisht si nga Marrëveshjet e OBT-së, ashtu edhe nga dispozita specifike në Marrëveshjet e MSA-së dhe në CEFTA 2006.⁶ Prandaj të gjithë anëtarët e CEFTA-s janë të gatshëm të aplikojnë MJT-të në përputhje me angazhimet e tyre ndërkombëtare, që synojnë të minimizojnë efektet në tregti.

Së fundi, MJT-të nuk ndikojnë domosdoshmërisht në uljen e tregtisë. Studime të ndryshme empirike kanë treguar se MJT-të veçanërisht ato teknike, mund të përmirësojnë tregtinë. Në rastin e barrierave teknike të tregtisë dhe masave sanitare dhe fitosanitare në mënyrë më specifike, dëshmitë empirike konfirmojnë se këto mund të rrisin ose ulin tregtinë dhe se harmonizimi dhe njohja e ndërsjellë janë mënyra në të cilat mund të zbusin efektet negative në tregti. Prandaj, rregulloret e hartuara mirë mund të kenë një efekt tregtar-lehtësues, edhe pse i ngrisin çmimet. Për shembull, në prani të asimetrisë së informacionit, vendosja e MJT teknike mund të rrisë besimin e konsumatorit, të ulë kostot e transaksionit dhe të promovojë tregtinë. Për më tepër, duhet theksuar se eksportuesit dhe prodhuesit vendorë mund të dallojnë në kapacitetet e tyre për t'u përshtatur me masat. Prandaj, zbatimi i një MJT të re mundet në fund të rritë importet e vendit që i vendosë MJT-t. Kjo mund të jetë rezultat, për shembull, i transpozimit të rregulloreve teknike të BE-së në vendet anëtare të CEFTA-s.

Nuk ka përkufizim të qartë të BJT-ve. Shumica e përkufizimeve shpjegojnë barrierat jotarifore në kuptim negativ. Një pengesë e pajustificueshme për tregtinë, ose BJT-ve ashtu siç po e përdorim në këtë raport, si e tillë ekziston ose paraqitet vetëm kur sjellja e një vendi në lidhje me aplikimin e MJT-ve është ose bëhet në kundërshtim me kushtet e zotimeve të saj ndërkombëtare detyruese ose legjislationin e saj të brendshëm; nëse është diskriminuese, nëse përgatitet, miratohet ose zbatohet me synimin ose me efektin e krijimit të një pengese të panevojshme për tregtinë ndërkombëtare, ose nëse e kufizon tregtinë më tepër se sa duhet. Për këtë arsye, BJT-t mund të dalin nga masat e vendosura politikisht, nga çështjet e legjislationit, dhe për shkak të mënyrës në të cilën zbatohen MJT-të. Këto të fundit janë përkufizuar si *pengesa procedurale*.

⁶ Për shembull, sa i përket MJT-ve teknike, BTT-të rregullohen në kapitullin IV të Marrëveshjes së CEFTA-s, e cila detyron të gjitha palët të zbatojnë Marrëveshjen e OBT-së për BTT-të. Neni 13 kërkon që "Palët të marrin përsipër të identifikojnë dhe të eliminojnë barrierat ekzistuese teknike të panevojshme në tregti brenda kuptimit të Marrëveshjes së OBT-së për BTT-të". Përveç kësaj, Palët "marrin përsipër të mos krijojnë pengesa të panevojshme teknike në tregti" dhe "duhet të informojnë Republikën... për çdo projekt tekst për një rregullore ose standard të ri teknik". Për më tepër, "Palët inkurajohen fuqishëm ... të harmonizojnë rregulloret e tyre teknike, standardet dhe procedurat për vlerësimin e konformitetit me ato në Komunitetin Europian". Marrëveshja përcakton një afat kohor konkret për veprim në lidhje me këtë çështje: "Palët angazhohen të hyjnë në negociata për të lidhur marrëveshje plurilaterale për harmonizimin e rregullave dhe standardeve të tyre teknike dhe njohjen reciproke të procedurave të vlerësimit të konformitetit ... para 31 dhjetorit 2010." Masat fitosanitare janë të rregulluara në kapitullin e produkteve bujqësore (III) dhe neni 12 i Marrëveshjes i obligon të gjitha palët të zbatojnë Marrëveshjen e OBT-së për zbatimin e masave fitosanitare. I njëjti nen kërkon që "Palët të bashkëpunojnë në fushën e masave sanitare dhe fitosanitare, duke përfshirë çështjet veterinarë, me qëllim të zbatimit të rregulloreve përkatëse në mënyrë jodiskriminuese." Përveç kësaj, i detyron palët të japin informacion mbi masat fitosanitare me kërkesë të një pale tjetër. Për më tepër, "Palët do të hyjnë, aty ku është e përshtatshme, në negociata për të lidhur marrëveshje për harmonizimin ose njohjen e ndërsjellë në tre çështje ..."

2 Eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA-së

Kjo pjesë e raportit paraqet një shtjellim të shkurtër të eksporteve të Kosovës në vendet anëtare të CEFTA-s. Tregtia me rajonin është shumë e rëndësishme për bizneset e Kosovës. Tregu i CEFTA-së përfaqëson tregun më të madh për eksportet e Kosovës. Të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme tregojnë vlerën e eksporteve për anëtarët e caktuar të vendeve të CEFTA-s, për periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2018. Nga të dhënat mund të bëjmë disa vrojtime të rëndësishme.

Tabela 2: Eksporti i mallrave në CEFTA, 2015-2018

Vendi/Viti	2015	2016	2017	2018	Rritja e eksporteve mes viteve 2015-2018
Shqipëria	40.25	36.41	53.29	66.27	64.64 %
Maqedonia Veriore	33.36	31.46	39.54	41.84	25.42 %
Serbia	32.26	39.75	46.35	32.19	- 0.21 %
Mali i Zi	12.14	13.17	19.17	18.53	52.63 %
Bosnja dhe Hercegovina	5.66	7.62	7.86	7.74	2.08 %
Totali i eksporteve në CEFTA (mil. €)	123.67	128.41	166.21	166.57	34.69 %
Totali i eksporteve (mil. €)	207.60	218.24	313.00	367.26	76.91%
% e eksporteve në CEFTA në totalin e eksporteve	59.57 %	58.84 %	53.10 %	45.35 %	

Statistikat e siguruar nga Doganat e Kosovës tregojnë se niveli i shkëmbimit tregtar mes Kosovës dhe anëtarëve të vendit të CEFTA-s është rritur nga viti në vit. Vlera e eksporteve në tregjet e CEFTA-s gjatë periudhës 2015 deri në vitin 2018 është rritur për 34.69%. Edhe pse kjo paraqet një rritje të ndjeshme, të dhënat tregojnë disa tendenca interesante:

Eksportet në CEFTA u rritën shumë më pak në krahasim me rritjen e përgjithshme të eksporteve. Për të njëjtën periudhë eksportet e përgjithshme u rritën për 76.91%. Si pasojë, pjesa e eksporteve në tregun e CEFTA-s ka rënë vit pas viti kur krahasohet me totalin e eksporteve. Derisa në vitin 2015 eksportet në CEFTA përfaqësonin 59.57% nga eksportet totale, në vitin 2018 ato u ulën në 45.35%. Kjo tregon se eksportet e Kosovës në tregje të tjera në veçanti në BE, i cili është një treg shumë më kërkues në lidhje me rregulloret dhe cilësinë e produkteve dhe destinacion tjetër kryesor i eksporteve të Kosovës, kanë pasur më shumë dinamizëm. Kjo mund të tregojë se eksportuesit e Kosovës po ballafaqohen me disa probleme të veçanta për të hyrë në tregjet e vendeve anëtare të CEFTA-s; e që mund t'i atribuohet efektit të BJT-ve, me të cilat ata po ballafaqohen.

Është interesante të theksohet ecuria e ndryshme e eksporteve të Kosovës në ato vende që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës krahasuar me vendet që nuk e kanë njohur. Në rastin e parë mund të vërehet një dinamizëm i dukshëm, ndërsa në rastin e fundit nuk ka eksporte si shembulli i Moldavisë ose praktikisht ka ngecje, madje edhe rënie si rastet e BeH-së dhe Serbisë. Kjo ecuri e diferencuar mund t'i atribuohet "kostos së mosnjohjes".

Gjithsesi, duhet të bëhet një analizë më e hollësishme për të shqyrtuar dallimet domethënëse në realizimin e eksporteve. Kjo analizë duhet të bëhet në nivel produkti duke identifikuar mbulimin e MJT-ve dhe veçoritë e zbatimit të tyre në secilin nga vendet e CEFTA-s. Çështja që duhet theksuar është se asnjë nga vendet e CEFTA-s nuk është përfshirë në bazat e të dhënave ndërkombëtare të MJT-ve që do të mundësonin kryerjen e vlerësimeve më gjithëpërfshirëse. Përfshirja në databazë të MJT-ve do të lejonte qasjen e thjeshtë të inventarit duke përdorur: indeksin e frekuencës, raportin e mbulimit dhe rezultatin e përhapjes për të kuptuar më mirë efektet e mundshme të MJT-ve në tregtinë brenda rajonit. Indeksi i frekuencës thjesht kap përqindjen e produkteve që i nënshtrohen një ose më shumë MJT-ve. Raporti i mbulimit kap përqindjen e importeve që i nënshtrohen një ose më shumë MT-ve. Rezultati i përhapjes kap numrin mesatar të MJT-ve që zbatohen për një produkt.

Mallrat më të eksportuara në vendet anëtare të CEFTA-s në vitin 2018 ishin:

Tabela 3:Produktet kryesore të eksportuara nga Kosova në CEFTA në vitin 2018

Kodi tarifar	Produkti	Vlera e eksportit (mil. €)	% ndaj totalit të eksporteve në CEFTA
7204	Kthime dhe mbetje ferrike; lingota mbetjesh të rishkrirëshme prej gize dhe çeliku:	24.20	14.30
7306	Tuba, tubacione dhe profile të tjera (psh, me tegele saldimi të hapura apo të salduara, perçinuar apo të mbyllur në mënyra të ngjashme), prej gize dhe çeliku:	12.30	7.38
2203	Birrë e bërë nga malti:	8.83	5.30
2716	Energjia elektrike	8.78	5.27
7404	Mbetjet dhe kthimet e bakrit:	8.74	5.25
7304	Tuba, tubacione dhe profile të zgavruara, pa tegel, prej gize (përveçse prej gize të derdhur) apo prej çeliku:	8.19	4.92
2607	Xeherore dhe koncentre plumbi	7.40	4.44
2202	Ujrat, përfshirë ujrat minerale dhe ujrat e gazuar, që përmbajnë sheqer apo lënde të tjera ëmbelsuese apo aromatizuese shtesë, dhe pije të tjera jo-alkoolike, pa përfshirë lëngun e frutave apo të zarzavateve të kreut Nr.2009:	7.09	4.26

Informacioni i paraqitur në tabelën e mësipërme tregon se shumica e mallrave të eksportuara në vitin 2018 ishin metale të vjetra, produkte nga metalet dhe mineralet. Përveç birrës dhe ujit, ushqimet e përpunuara dhe produktet bujqësore nuk janë brenda këtij grupi.

3 Metodologjia

Hulumtimi është bërë duke shfrytëzuar të dhënat primare të mbledhura përmes takimeve dhe intervistave me përfaqësuesit e 50 bizneseve në Kosovë. Bazuar në statistikën tregtare të ofruara nga Doganat e Kosovës, numri i përgjithshëm i kompanive të cilat kanë eksportuar në vendet e CEFTA-s në 2018, ishte 198 kompani.

Bazuar në vlerën e eksporteve të tyre në vendet e CEFTA-s në 2018, këto kompani mund të klasifikohen si të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4: Kompanitë që eksportojnë në vendet e CEFTA-s në 2018

Vlera e eksporteve (EURO)	Numri i kompanive	%
0 – 100,000	114	57.58
100,000 – 500,000	43	21.72
500,000 – 1,000,000	17	8.58
1,000,000 – 5,000,000	15	7.57
5,000,000 -	9	4.55
Totali	198	100 %

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 3, shohim se shumica e kompanive të cilat kanë eksportuar në vendet e CEFTA-s gjatë vitit 2018 janë kompani me vlerë të ulët të mallrave të eksportuara. Vetëm 9 nga 198 kompani kanë eksportuar në vlerë prej më shumë se 5 milionë euro individualisht. Nga numri i përgjithshëm i kompanive që kanë eksportuar në vendet e CEFTA-s, është përzgjedhë një mostër që synonte përfshirjen e eksportuesve kryesorë dhe mbulimin e një sërë sektorësh të rëndësishëm. Kompanitë e përfshira në mostër kanë përfaqësuar më shumë se 58% të totalit të eksporteve të mallrave në vendet e CEFTA-s gjatë vitit 2018.⁷

Në studim janë përfshirë edhe disa kompani që nuk janë në listën e kompanive eksportuese në CEFTA. Kjo është bërë me qëllim për të gjetur se pse ata nuk po eksportojnë në CEFTA përderisa janë prodhues të mirënjohur në Kosovë dhe po eksportojnë në vende të tjera jashtë CEFTA-s. Intervistat u zhvilluan në bazë të një pyetësi, i cili u përgatit në mënyrë specifike për këtë hulumtim.

Pyetësi është paraqitur në Shtojcën 1. Në rastin e disa kompanive nevojitej më shumë se një takim për të mbledhur informacionin e nevojshëm.

Intervistat janë kryer nga eksperti i lartë, së bashku me stafin e Departamentit të Tregtisë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Zgjedhja e kompanive është bërë në bazë të:

- Industrisë
- Vendlindjes së destinacionit
- Madhësisë së kompanisë
- Selisë së kompanive

Industria

Kompanitë e intervistuar vijnë nga këto industri:

⁷ Të dhënat e Doganës së Kosovës për 2018

Tabela 5: Shpërndarja e mostrës sipas sektorit të aktivitetit ekonomik

Industria	Nën-sektori	Numri i kompanive
Bujqësia dhe produktet ushqimore	Përpunimi i ushqimit	13
	Bujqësi	9
	Verë, alkool dhe prodhim birre	3
	Mbledhja dhe përpunimi i lëkurës së kafshëve	1
Totali		26
Industritë e tjera	Industria e përpunimit të metaleve	8
	Produktet nga plastika	5
	Materiale Ndertimi	4
	Materialet e paketimit	2
	Riciklimi i letrës	2
	Industria Farmaceutike	1
	Nxjerrja e mineraleve	1
	Prodhimi i dyshekëve	1
Totali		24
Totali i përgjithshëm		50

Vendi i destinacionit

Bazuar në statistikat e marra nga Dogana e Kosovës, eksportet e kompanive të përzgjedhura shkuan në këto vende anëtare të CEFTA-s:

- Shqipëri
- Serbi
- Maqedoni Veriore
- Bosnje dhe Hercegovinë
- Mali i Zi⁸

Madhësia e kompanisë

- Gjashtë nga kompanitë e intervistuar janë kompani të vogla me deri në 10 punëtorë dhe me qarkullim vjetor prej më pak se 0.5 mil euro.
- 32 prej tyre janë kompani me madhësi mesatare deri në 100 punëtorë/qarkullim vjetor prej 0.5-5 mil. Euro.
- 12 prej tyre janë kompani të mëdha me mbi 100 punëtorë dhe me qarkullim vjetor mbi 5 milion Euro.

Lokacioni i kompanive

Kompanitë e përzgjedhura gjenden në tërë Kosovën. Lista me emrat e kompanive dhe vendet ku ato gjenden është e paraqitur **në Shtojcën 2**.

⁸ Bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës nuk ka pasur eksport të mallrave nga Kosova në Moldavi

4 Rezultatet nga hulumtimi

Tregu i CEFTA-së përfaqëson tregun më të madh për eksportuesit e Kosovës. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës për vitin 2018, eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA-së kanë arritur vlerën prej 166.57 milionë euro nga eksportet totale prej 367.26 milionë euro, që përfaqësonin 45.35% të totalit të eksporteve vendore.⁹

Eksportet në vendet individuale të CEFTA-së në vitin 2018 ishin si më poshtë:

Tabela 6: Eksportet e Kosovës në vendet e CEFTA-s në 2018

Vendi	Eksportet vendore	Ri-eksportet	Eksportet e përkohshme	% e eksporteve vendore
Shqipëria	66.27	25.53	1.27	39.79
Maqedonia Veriore	41.84	11.17	0.27	25.12
Serbia	32.19	10.32	0.53	19.32
Mali I Zi	18.53	5.07	0.40	11.12
Bosnja dhe Hercegovina	7.74	1.27	0.002	4.65
Totali	166.57	53.36	2.47	100.00

Kompanitë janë pyetur për rëndësinë e eksportit për bizneset e tyre. Në pyetjen lidhur me pjesën e eksporteve nga qarkullimi i përgjithshëm dhe pjesën e eksporteve në vendet e CEFTA-s nga eksportet e tyre totale, të anketuarit u përgjigjën si më poshtë:

Tabela 7: Pjesët e eksporteve nga qarkullimi i përgjithshëm dhe eksportet në CEFTA nga eksportet totale

Pjesa e eksporteve në grupet totale të qarkullimit (%)	Shpërndarja e kompanive sipas pjesëmarrjes së eksporteve në qarkullimin e përgjithshëm (%)	Shpërndarja e kompanive sipas pjesëmarrjes së eksporteve në CEFTA në totalin e eksporteve (%)
0	4	8
0-10	20	6
10-50	44	28
50-80	8	12
80-100	24	46

Kompanitë janë pyetur në lidhje me vlerën e eksporteve të tyre në raport me qarkullimin e tyre total. 8% e kompanive të intervistuar deklaruan se nuk janë duke eksportuar në CEFTA. Përdorisa për më shumë se 68% të të anketuarve eksportet përfaqësojnë më pak se 50% të qarkullimit total të tyre, për 24% të ndërmarrjeve të intervistuar eksportet përfaqësojnë 80-100% të qarkullimit të tyre total. Kjo tregon se ¼ e kompanive të intervistuar janë të orientuara nga eksporti dhe eksportimi është jetik për ekzistencën dhe zhvillimin e tyre.

⁹ Të dhënat e Doganës së Kosovës për vitin 2018

Kompanitë gjithashtu janë pyetur në mënyrë specifike lidhur me eksportet e tyre në vendet e CEFTA-së dhe pjesën e saj në krahasim me eksportet e tyre totale. Nga përgjigjet e marra, është e qartë se tregu i CEFTA-s paraqet një treg shumë të rëndësishëm për këto kompani. 46% e kompanive të intervistuar deklaruan se eksportojnë në vendet e CEFTA-s ndërmjet 80-100% të totalit të eksporteve të tyre.

Të pyetur për përvojën e tyre gjatë eksportit në vendet e CEFTA-s në aspektin e lehtësisë së hyrjes së produkteve të tyre në treg dhe trajtimit të dhënë nga autoritetet e vendit të destinacionit, ata u përgjigjën si më poshtë:

Tabela 8: Mendimi i të anketuarve lidhur me lehtësinë e eksportimit në vendet e CEFTA-s

Nr. i komp. / %	Shqiperia (34) %		Mali i Zi (21) %		Maqedonia Veriore (31) %		B&H (20) %		Serbia (27) %	
Jo mirë	(8)	23	(3)	14	(2)	6	(4)	20	(14)	52
Kënaqshëm	(5)	15	(2)	9.5	(3)	10	(0)	0	(0)	0
Mirë	(14)	41	(13)	62	(20)	65	(14)	70	(11)	41
Shumë mirë	(7)	21	(2)	9.5	(6)	19	(2)	10	(2)	7
Shkëlqyeshëm	(0)	0	(1)	5	(0)	0	(0)	0	(0)	0

Informacioni i marrë nga të anketuarit tregon se shumica e tyre nuk janë të kënaqur me trajtimin nga autoritetet e vendeve të destinacionit. Sipas këtyre të dhënave, autoritetet serbe kryesojnë me këtë, me 52% të të anketuarve duke thënë se nuk janë trajtuar mirë prej tyre, pasuar nga autoritetet shqiptare me 23% të të anketuarve dhe autoritetet e Bosnjës dhe Hercegovinës me 20% të të anketuarve. Sipas të anketuarëve, kjo situatë kryesisht rezulton nga barrierat me të cilat ballafaqohen gjatë eksportimit, mosnjohjes së certifikatave të cilësisë dhe atyre fitosanitare/veterinës dhe të dokumenteve të tjera të lëshuara nga autoritetet e Kosovës.

Të pyetur nëse gjatë eksportimit në vendet e CEFTA-s ata kanë hasur në ndonjë vështirësi apo pengesë, për të cilën ata mendojnë se nuk ishte pjesë e një procedure normale, ose mendojnë se ka pasur kërkesa jo të justifikuara ose joproporcionale:

- 34% e të anketuarve thanë se nuk u përballën me vështirësi apo pengesa të tilla, ndërsa
- 66% e të anketuarve konfirmuan se u përballën me vështirësi/pengesa në eksport në vendet e CEFTA-së.

Në pyetjen lidhur me numrin e vendeve të CEFTA-s në të cilat ata kanë eksportuar në vitin 2018:

- 8% e të anketuarve thanë se nuk kanë eksportuar në CEFTA;
- 16% e të anketuarve thanë se kanë eksportuar vetëm në një vend;
- 24% e tyre kanë eksportuar në 2 vende;
- 26% e tyre kanë eksportuar në 3 vende;
- 12% e tyre kanë eksportuar në 4 vende;
- 14% e tyre kanë eksportuar në 5 vende;

Përgjigjet e marra në lidhje me numrin e vendeve të CEFTA-s në të cilat ata kanë eksportuar gjatë vitit 2018, tregojnë se numri i kompanive, të cilat kanë eksportuar në të gjitha vendet e CEFTA-s është 0, pasi nuk ka pasur eksport në Moldavi. Përgjigjet gjithashtu tregojnë se numri i kompanive që kanë eksportuar në 5 vende është vetëm 14% e tyre. Të anketuarit e shpjeguan këtë situatë si rezultat të vështirësive dhe pengesave me të cilat ballafaqoheshin kur u përpoqën të eksportonin në disa nga anëtarët e CEFTA-së, çka i detyroi ata të largohen nga planet e tyre për të eksportuar në më shumë vende brenda CEFTA-së dhe që të kufizojnë eksportet e tyre vetëm në një ose dy vende ku u përballën me më pak vështirësi.

4.1 Pengesat dhe barrierat për të eksportuar në vendet e CEFTA-s

Pengesat dhe barrierat që ata kanë raportuar janë të ndryshme nga një vend në tjetrin dhe mund të ndahen në dy grupe:

1. Ato që lidhen me statusin politik të Kosovës dhe mos njohjen e pavarësisë së saj nga tre anëtarë të CEFTA-s.

Nuk ka eksport në Moldavi.

4.1.1 Eksportimi në Serbi

- Në Serbi, prodhuesit e verës nuk mund të eksportojnë verë në shishe qelqi për shkak të etiketës që thotë se produkti është prodhuar në Kosovë. Ata eksportojnë verë në depozita të mëdha (tankera) por jo në shishe dhe jo të etiketuar.
- Të gjitha certifikatat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës duhet të kenë status neutral, që do të thotë se nuk duhet të ketë asnjë shenjë që ka lidhje me Republikën e Kosovës.
- Prodhuesi farmaceutik nga Kosova nuk mund të eksportojë në Serbi për shkak të kërkesës për t'u regjistruar tek autoritetet serbe si eksportues nga Kosova dhe atyre u është thënë se regjistrimi nuk do të aprovohet nga autoritetet serbe, pasi ata nuk pranojnë asnjë dokument të lëshuar nga autoritetet e Kosovës nëse dokumenti nuk ka status neutral.
- Prodhuesve të produkteve nga plastika e ricikluar nuk u lejohet të eksportojnë në Serbi në qoftë se në paketën e prodhimeve të tyre është shkruar deklarata se këto produkte janë prodhuar nga një kompani e Kosovës.
- Serbia nuk njeh certifikatën e cilësisë të lëshuar nga autoritetet e Kosovës për materialet e izolimit të përdorura në ndërtim.
- Kompanitë nuk mund të eksportojnë në Serbi duke përdorur transportuesit lokal për shkak të mosnjohjes së targave të automjeteve.
- Prodhuesit e Kosovës nuk lejohen të aplikojnë në tenderët e prokurimit publik në Serbi.
- Kompanitë, të cilat mbledhin letër dhe karton të përdorur, nuk mund të eksportojnë në Serbi, pasi që kompanitë importuese nga Serbia nuk janë të licencuara nga autoritetet e tyre për importim nga Kosova.

4.1.2 Eksportimi në Bosnjë dhe Hercegovinë

- Për të transportuar mallra në Bosnjë dhe Hercegovinë, shoferi kosovar ka nevojë për vizë hyrëse. Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia janë vendet e vetme në kuadër të marrëveshjes së CEFTA-s, të cilat aplikojnë vizë hyrëse për qytetarët e Kosovës.
- Përveç kërkesës për vizë për shoferin, kompanitë e Kosovës nuk mund të përdorin transportin e tyre, pasi Bosnja dhe Hercegovina nuk i njeh targat e automjeteve të Kosovës.
- Të gjitha certifikatat e lëshuara nga autoritetet e Kosovës duhet të kenë status neutral, që do të thotë se nuk duhet të ketë shenja të e Republikës së Kosovës.
- Prodhuesit e Kosovës nuk lejohen të aplikojnë në tenderët e prokurimeve publike të publikuara nga autoritetet në Bosnjë dhe Hercegovinë.
- Prodhuesi kosovar i patateve nuk është lejuar të eksportojë në Bosnjë dhe Hercegovinë, pasi përveç certifikatës fitosanitare të lëshuar nga autoritetet e Kosovës, autoritetet e B&H kanë kërkuar nga eksportuesi të prezantojë një certifikatë fitosanitare të lëshuar nga autoritetet serbe.
- Prodhuesit farmaceutik nga Kosova nuk mund të eksportojë në B & H për shkak të kërkesës që të jenë të regjistruar pranë autoriteteve të B & H si eksportues nga Kosova dhe atyre u është thënë se regjistrimi nuk do të aprovohet nga Autoritetet B & H sepse nuk pranojnë asnjë dokument të lëshuar nga autoritetet e Kosovës nëse dokumenti nuk ka status neutral.

2. Pengesat dhe barrierat që lidhen me veprimet administrative të ndërmarra nga autoritetet e vendeve të destinacionit

4.1.3 Pengesat për të eksportuar në Shqipëri

- Në çdo eksport, autoritetet shqiptare kërkojnë kopjen origjinale (ose kopjen e noterizuar) të Certifikatës së Cilësisë për produktet që i nënshtrohen kontrollit fitosanitar dhe veterinar. Kjo kërkesë e autoriteteve shqiptare po shkakton kosto shtesë financiare për eksportuesit e Kosovës dhe konsumon shumë kohën e tyre, të cilën ata duhet të shpenzojnë për marrjen e certifikatës.
- Procedurat e zhdoganimit në Shqipëri janë të komplikuar. Megjithatë pritej që marrëveshja ndërmjet dy qeverive të lehtësonte shkëmbimin tregtar midis Kosovës dhe Shqipërisë, kur eksporti të shkojë nga Kosova në Shqipëri, ngarkesa do të ndalet nga autoritetet doganore shqiptare në PKK Morinë dhe kompania shqiptare importuese duhet të parashtojë kërkesë për tranzit të brendshëm të mallrave, nga kufiri në terminalin doganor të brendshëm. Kur tranziti miratohet, kamioni duhet të shkojë në terminalin doganor më të afërt ku është regjistruar kompania importuese.
- Nëse kompania eksportuese ka ngarkuar dy ose më shumë ngarkesa në të njëjtin kamion dhe destinacioni përfundimtar nuk është në të njëjtin vend, procedurat doganore nuk mund të kryhen në një terminal të vetëm doganor, por kamioni duhet të lëvizë nga njëri në tjetrin terminal doganor.
- Një pengesë tjetër nga doganat shqiptare është kërkesa për skanimin e dërgesave. Zgjedhja e dërgesave për skanim bëhet në bazë të analizës së riskut. Edhe pse jo të gjitha dërgesat skanohen, për ato që janë përzgjedhur dhe nëse vlera e mallrave në dërgesë është mbi 1,000 Euro, ka një tarifë prej 22 Euro, të cilën ata duhet ta paguajnë për skanim.

Ka disa pengesa të tjera të raportuara mbi eksportimin në Shqipëri, por këto pengesa duhet të klasifikohen si masa tarifore dhe jo tarifore se sa barriera jo-tarifore:

- Mospranimi i vlerës së transaksionit nga Autoritetet Doganore dhe aplikimi i metodave të tjera për vlerësimin e mallrave në import.
- Zbatimi i normës më të lartë të akcizës për produktet e importuara të prodhuara nga plastika në krahasim me normën e akcizës të aplikueshme për produktet e njëjta të prodhuara në Shqipëri.
- Shqipëria aplikon norma më të larta të akcizës mbi verën dhe birrën nëse kapaciteti prodhues i prodhuesit / eksportuesit është më i madh se 1 milion litra verë apo birrë në vit.

4.1.4 Pengesat për të eksportuar në Serbi

- Për pijet e eksportuara në Serbi, autoritetet serbe kërkojnë teste shtesë për çdo eksport. Ata marrin mostrat e produkteve dhe i dërgojnë ato në laboratorët në Serbi. Zakonisht merrë shumë kohë për të përfunduar këto teste dhe nganjëherë ngarkesat mbahen për më shumë se 40 ditë në terminalin doganor përpara se të përfundojnë zhdoganimin. Kostoja për testet laboratorike dhe për shërbimet e terminalit nuk i bënë ato më konkurruese dhe shumica e kompanive të intervistuar kishin ndërprerë eksportin në Serbi pas përvojës së parë.
- Autoritetet serbe kërkojnë që dokumentet gjithmonë të përgatiten në gjuhën serbe.
- Kompanitë që grumbullojnë metale të vjetra, nuk lejohen të shesin ose të kalojnë këto mallra përmes Serbisë. Sipas tyre, autoritetet serbe u kanë thanë atyre se eksportuesit e Kosovës nuk mund të eksportojnë në Serbi apo të kalojnë tranzit, sepse Kosova nuk është anëtare e "Konventës së Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre".

- Eksportimi i pemëve dekorative të prodhuara në Kosovë u refuzua, me sqarime verbale se pemët dekorative nuk mund të eksportohen në Serbi.
- Në kufirin midis Kosovës dhe Serbisë, zyrtarët fitosanitarë serbë punojnë me orar të reduktuar të punës. Pas orës 14:00 nuk ka prani të inspektorëve në kufi, gjë që i detyron ata të presin atje deri në ditën tjetër.

4.1.5 Pengesat për të eksportuar në Maqedoninë Veriore

- Prodhuesit e miellit janë ankuar se autoritetet maqedonase kërkojnë teste shtesë për çdo eksport. Kostoja e këtyre testeve dhe vonesat e shkaktuara nga kjo i shtynë të ndërpresin eksportin.
- Një ndërmarrje për përpunimin e mishit në Kosovë u refuzua të eksportoje në Maqedoni, me arsyetimin e autoriteteve maqedonase se prodhuesi në Kosovë nuk posedon një magazinë adekuate për ruajtjen e produkteve përfundimtare.
- Procedurat e zhdoganimit në Maqedoni marrin shumë kohë.

4.1.6 Pengesat për të eksportuar në Mal të Zi

- Autoritetet e Malit të Zi shpesh kërkojnë teste shtesë për mallrat, të cilat janë subjekt i kontrollit fitosanitar dhe veterinar, pasi ato nuk mbështeten në testet e përfunduara në Kosovë.
- Një prodhues lokal i bletarisë nuk u lejua të eksportoje në Mal të Zi me arsyetimin se ata nuk besojnë se në Kosovë ekzistojnë kushte për prodhimin e këtyre produkteve.

4.1.7 Pengesat për të eksportuar në Bosnjë dhe Hercegovinë

- Kompanitë të cilat mbledhin metale të vjetra nuk lejohen të shesin ose të kalojnë tranzit këto mallra përmes Bosnjës dhe Hercegovinës. Sipas tyre, autoritetet e B & H u thanë atyre se eksportuesit e Kosovës nuk mund të eksportojnë në Bosnje dhe Hercegovinë apo të kalojnë tranzit për shkak të faktit se Kosova nuk është anëtare e "Konventës së Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre". Përfaqësuesit e këtyre kompanive konfirmuan se Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi nuk i ndalojnë ata të eksportojnë në këto tre vende apo të kalojnë tranzit përmes tyre.
- Autoritetet e B & H shpesh kërkojnë teste shtesë për mallrat, të cilat janë subjekt i kontrollit fitosanitar dhe veterinar, pasi ato nuk mbështeten në testet e kryera në Kosovë.

Në pyetjen lidhur me mendimin e tyre për shkak të veprimeve të tilla të ndërmarra nga autoritetet e vendeve të destinacionit:

- 24% e të anketuarve thanë se mendojnë se kjo po ndodh, pasi ata duan të kufizojnë importet nga Kosova.
- 14% prej tyre mendojnë se kjo është për shkak të mungesës së marrëveshjeve të ndërsjella ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe autoriteteve nga vendi i destinacionit.
- 8% e tyre mendojnë se kjo është për shkak të sjelljes korruptive.
- 4% e të anketuarve mendojnë se kjo është për shkak të mungesës së procedurës ligjore.
- 4% e të anketuarve mendojnë se kjo është për shkak të mbrojtjes së tregut, ndërsa
- 46% e të anketuarve nuk kanë pasur ndonjë mendim për këtë.

Shumica e të anketuarve (46% e tyre) nuk e dinin arsyen e veprimeve të tilla të ndërmarra nga autoritetet, ndërsa 24% e tyre mendojnë se kjo ndodhë sepse ata duan të kufizojnë importet nga Kosova.

Të pyetur se sa mirë ata janë të informuar për kërkesat e ndryshme dhe rregulloret e importit në vendet e ndryshme dhe për modifikimet që ndodhin në kërkesat dhe rregulloret dhe nëse ata konsiderojnë se ka vështirësi në marrjen e informacionit të nevojshëm në kohë,

- 26% e të anketuarve thanë se e marrin këtë informacion nëpërmjet klientëve dhe shpërndarësve të tyre nga vendi i destinacionit.
- 20% e të anketuarve thanë se janë informuar përmes agjentëve të tyre shpërndarës të mallrave.
- 10% thanë se marrin informacion përmes mediave dhe portaleve të internetit.
- 6% thanë se informohen për ndryshimet vetëm pasi të hasin në vështirësi në kufi dhe se vozitësit i informojnë.
- 6% thanë se ata kanë përfaqësuesit e tyre në këto vende të cilët i informojnë.
- 32% e tyre nuk janë të informuar dhe nuk dinë si ta marrin këtë informacion.

Shumica e kompanive po përballen me vështirësi për të marrë informacion në kohë lidhur me ndryshimet ligjore në rregulloret e importit në vendet e CEFTA-s ku eksportojnë. 32% e tyre thanë se nuk dinë si ta marrin këtë informacion, ndërsa 26% e të anketuarve thanë se e marrin këtë informacion nëpërmjet klientëve të tyre.

Të pyetur për reagimin e tyre kur u përballën me pengesa në eksport,

- 34% e tyre thanë se i kanë njoftuar autoritetet e Kosovës.
- 2% prej tyre u ankuan tek autoritetet e vendit të destinacionit.
- 2% vendosën të ndalojnë eksportimin, dhe
- 62% e tyre nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim.

Shumica e të anketuarve (62% e tyre) thanë se nuk i kanë njoftuar autoritetet e Kosovës, as autoritetet e vendit të destinacionit për pengesat me të cilat ballafaqohen gjatë eksportimit në vendet e CEFTA-s. Të pyetur pse nuk e bënë këtë, përgjigjet që morën ishin se nuk besonin se autoritetet e Kosovës mund të bënin shumë për t'i ndihmuar ata që t'i zgjidhnin këto pengesa, sidomos kur kjo ju ka ndodhë gjatë eksportimit në Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Disa nga të anketuarit shprehën pakënaqësi me Qeverinë e Kosovës dhe thanë se nuk besojnë se Qeveria është e interesuar t'i ndihmojë ata në zgjidhjen e këtyre problemeve pasi ata besojnë se nuk janë në vëmendjen e Qeverisë.

4.2 Pengesat dhe procedurat e brendshme në Kosovë që ndikojnë në eksport

Të pyetur se çfarë mund të bëjnë autoritetet e Kosovës për t'i ndihmuar, ata paraqitën një numër çështjesh dhe procedurave të zbatuara nga autoritetet lokale, të cilat i shohin si pengesa për ta në eksport.

Ata dhanë disa propozime se si të përmirësojnë situatën në mënyrë që të mund të eksportojnë me lehtësi:

- **Të rritet numri i zyrtarëve fitosanitarë**

Shumica e eksportuesve, të cilët prodhojnë ushqime dhe pije që janë subjekt i kontrollit fitosanitar dhe veterinar, u ankuan për mungesën e stafit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Zyrat rajonale të AUV-it nuk kanë mjaft personel dhe kjo po krijon shumë vështirësi për eksportuesit, të cilëve u nevojitet shumë kohë për të marrë certifikatat e eksportit.

- **Të zvogëlohet numri i mostrave të cilat ata duhet t'i dërgojnë në Zyrat e AUV-it**

Kjo është një çështje tjetër e ngritur nga eksportuesit. Për të marrë certifikatën e eksportit, së pari, ata duhet të dërgojnë mostrat e produkteve të tyre në Institutin e Shëndetit Publik dhe pasi të marrin Certifikatën e cilësisë të lëshuar nga ky Institut, ata duhet të aplikojnë për certifikatën e eksportit në zyrën rajonale të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në regjionin ku është i regjistruar biznesi. Për të marrë certifikatën e eksportit, ata duhet të dërgojnë mostra shtesë në zyrën e AUV-it. Sipas mendimit të tyre, autoritetet nuk duhet të kërkojnë mostra për çdo eksport individual. Rregullat e aplikuara nga Institucionet e Kosovës kërkojnë që kompanitë të dërgojnë së paku 2 mostra për agjencitë specifike për secilin produkt që e eksportojnë. Kjo do të thotë që kompanitë të cilat prodhojnë prodhime bujqësore, ushqime të përpunuara dhe pije, duhet të dërgojnë 2 mostra për çdo produkt të eksportuar në Institutin e Shëndetit Publik dhe 2 mostra të tjera në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

- **Të bëhet koordinimi me operatorët e terminaleve të brendshme doganore, në mënyrë që ata të paguajnë më pak tarifë për shfrytëzimin e shërbimeve të këtyre terminaleve**

Nëse sistemi i profilizimit të riskut të Doganave zgjedh ngarkesën si ngarkesë me rrezik të lartë, para se të largohet nga vendi, dërgesa duhet të shkojë në terminalin doganor të brendshëm për inspektim. Tarifën që ata duhet të paguajnë për shfrytëzimin e objekteve është 40 Euro dhe bizneset mendojnë se duhet të paguajnë më pak. Tarifa prej 40 Euro zbatohet në çdo dërgesë që hyn në terminal dhe kjo shumë aplikohet për periudhën deri në orën 24:00. Nëse kamioni qëndron edhe vetëm për pak minuta, ata përsëri duhet të paguajnë shumën e plotë. Nëse procedurat zgjasin më shumë se 24 orë, kompanitë duhet të paguajnë 40 euro shtesë për ditën e dytë të shfrytëzimit të objekteve të terminalit.

- **Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike**

Disa biznese nga vende të ndryshme të Kosovës ngritën çështjen e mungesës së furnizimit të rregullt të energjisë elektrike dhe çmimit që ata paguajnë, si një pengesë për prodhimin dhe rritjen e aftësisë së tyre konkurruese. Sipas tyre, kjo situatë do të përkeqësohet nëse çmimi i energjisë elektrike do të rritet siç edhe kanë dëgjuar nga autoritetet. Kohët e fundit, zyrtarët e Zyrës së Rregullatorit për Energji kanë deklaruar në media se së shpejti çmimi i energjisë elektrike pritet të rritet deri në 50% nga çmimi aktual dhe kjo lidhet me projektin e ri të termocentralit.

- **Të angazhohen më shumë në mbrojtjen e prodhuesve vendor nga importet e padrejta dhe importet e mallrave jo cilësore**

Disa biznese u ankua për importet e padrejta nga regjioni dhe presin që Qeveria duhet të bëjë më shumë për t'i mbrojtur ato nga këto importe. Sipas tyre, importet që vijnë nga rajoni shpesh vijnë me çmime të ulëta dampuese dhe si mallra jo cilësore, çka dëmton gjasat e tyre të rrisin nivelin e prodhimit dhe të konkurrojnë me ta.

- **Të ndihmojnë në luftën kundër perceptimit negativ për mallrat e prodhuara në Kosovë**

Bizneset u ankuan se po përballen me vështirësi në eksportim për shkak të perceptimit negativ që ekziston në lidhje me cilësinë e mallrave të prodhuara në Kosovë. Ata besojnë se Qeveria mund t'i ndihmojë ata që ta luftojnë këtë perceptim.

- **Të ndihmohen në gjetjen e partnerëve tregtarë jashtë Kosovës**

Disa nga bizneset u ankuan se kishin vështirësi të gjejnë partnerë tregtarë në vende të tjera jashtë Kosovës. Ata mendojnë se Qeveria e Kosovës mund t'i ndihmojë të gjejnë partnerë tregtarë, duke organizuar më shumë panaire dhe duke i ndihmuar ata që të marrin pjesë në panaire ndërkombëtare.

- **Të zvogëlohet koha e nevojshme për marrjen e lejes së eksportit për eksportin e letrës së përdorur, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

Kompanitë, të cilat grumbullojnë letra të përdorura, u ankuan lidhur me procedurat dhe kohën e nevojshme për të marrë licencën e eksportit, e cila lëshohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas tyre, këto procedura janë tepër burokratike dhe marrin shumë kohë.

- **Të shfuqizohet detyrimi ligjor për të marrë një certifikatë fitosanitare dhe veterinare për çdo eksport**

Sipas legjislacionit aktual, për çdo eksport ekziston një kërkesë për marrjen e certifikatës fitosanitare ose veterinare. Bizneset mendojnë se kjo nuk duhet të jetë e detyrueshme për çdo ngarkesë dhe veçanërisht duke marrë parasysh faktin që autoritetet e vendit të destinacionit bëjnë testimet e tyre dhe nuk mbështeten në certifikatat e Kosovës.

- **Të rritet numri i stafit doganor në Departamentin e TARIK dhe rregullat e origjinës së mallrave**

Disa nga të anketuarit mendojnë se numri i stafit të Doganës së Kosovës i angazhuar në departamentet për klasifikimin e tarifave dhe rregullat e origjinës së mallrave duhet të rritet. Kjo do t'i ndihmonte ata që të merrnin më shpejt informacionin që iu nevojitet mbi çështjet tarifore dhe rregullat e origjinës së mallrave.

- **Të lehtësohet procedura për marrjen e licencave për shfrytëzim të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Minerave dhe Minieraleve**

Prodhuesit e produkteve të ndërtimit nga argjila u ankuan lidhur me procedurën e aplikuar nga Agjencia e Kosovës për Minera dhe Minierale në lidhje me lëshimin e licencave për shfrytëzim. Sipas tyre, këto procedura iu marrin shumë kohë dhe energji dhe rrisin koston e tyre të prodhimit.

- **Të rritet numri i zyrtarëve të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale, pasi marrja e licencës për eksport merr shumë kohë për shkak të mungesës së stafit**

Prodhuesit e produkteve farmaceutike u ankuan se për shkak të mungesës së stafit brenda AKPM-së, procedura për të marrë një leje eksporti ose importi i merr atyre shumë kohë. Edhe pse aplikimi në internet ka lehtësuar procedurën, kjo procedurë ende zgjat 2-5 ditë dhe ata nuk mund të bëjnë asgjë në lidhje me aktivitetet e tjera të tilla siç janë procedurat e zhdoganimit ose ngarkimi i mjetit të tyre transportues para se të marrin licencën.

5 Të gjeturat

Gjatë zbatimit të aktivitetit janë identifikuar këto gjetje:

- CEFTA është një treg shumë i rëndësishëm për eksportuesit e Kosovës. Të dhënat e mbledhura tregojnë se për 46% të të anketuarve eksporti në tregun e CEFTA-së përfaqëson ndërmjet 80-100% të totalit të eksporteve të tyre. Megjithatë, raporti tregon se eksportet në CEFTA për periudhën 2015-2018 u rritën më ngadalë krahasuar me eksportet në vendet e tjera. Në vitin 2018, eksportet në CEFTA përfaqësuan 45.35% të totalit të eksporteve, ndërsa në vitin 2015 kjo ishte në nivelin 59.57% të totalit të eksporteve. Kjo mund të sugjerojë që kompanitë kosovare janë duke gjetur qasje më të lehtë në tregje të tjera, në vend që të eksportojnë në tregun e CEFTA-s.
- Eksportuesit e Kosovës po përballen me vështirësi dhe pengesa gjatë eksportimit në vendet e CEFTA-s. Këto pengesa nuk mund të klasifikohen vetëm si barriera jo-tarifore, pasi disa prej tyre përfaqësojnë shkelje të drejtpërdrejtë të marrëveshjes së CEFTA-s. Dy shembuj të kësaj natyre janë zbatimi i normave më të ulëta të akcizës për prodhuesit vendor të plastikës në Shqipëri krahasuar me ato të importit, ose kufizimi i zbatuar ndaj eksportuesve të Kosovës për të aplikuar në tenderët publik në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë.
- Përvoja e kompanive të Kosovës që eksportojnë në vendet e CEFTA-s ndryshon nga një vend në tjetrin. Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, 52% e të anketuarve thanë se nuk kishin eksperiencë të mirë gjatë eksportimit në Serbi, pasuar nga 23% e tyre me përvojë jo të mirë gjatë eksportimit në Shqipëri dhe 20% me përvojë jo të mirë gjatë eksportimit në Bosnjë dhe Hercegovinë.
- Hulumtimi tregon se 8% e kompanive të intervistuar nuk kanë eksportuar në CEFTA, të cilat pasohen nga 16% kompani të tjera, të cilat kanë eksportuar vetëm në një vend. Vetëm 14% e kompanive kanë eksportuar në pesë vende. Sipas të anketuarve, pengesat me të cilat u ballafaquan kur u përpoqën të eksportojnë në disa nga vendet anëtare të CEFTA-s, i detyruan ata të ndryshonin planet e tyre për të eksportuar në ato vende dhe të ndalonin eksportin ose të eksportonin vetëm në një vend, ku ata përballeshin me më pak vështirësi.
- Pengesat dhe barrierat me të cilat ballafaqohen kompanitë kosovare gjatë eksportit në vendet e CEFTA-s, janë më të shpeshta në eksportin e mallrave ku kërkohet një licencë ose certifikatë specifike. Të dhënat e mbledhura nga të anketuarit tregojnë se shumica e produkteve të prekura janë ushqimet dhe pijet, ndërsa për produktet e tjera industriale për të cilat nuk kërkohet ndonjë licencë specifike përveç dokumenteve të rregullta të eksportit (deklarata doganore eksportuese, fatura, çertifikata e origjinës / EUR1), ka më pak pengesa për eksportimin e tyre.
- Statistikat në lidhje me mallrat e eksportuara në vitin 2018, tregojnë se produktet bujqësore dhe ushqimet e përpunuara nuk janë në grupin e produkteve më të eksportuara. Kjo mund të sugjerojë se kjo ndodhë për arsye se produktet më të prekura nga BJT-e janë mallrat bujqësore dhe ushqimore të përpunuara, për shkak të vështirësive me njohjen e certifikatave fitosanitare dhe veterinarë.
- Të dhënat e mbledhura tregojnë se megjithëse numri i kompanive nga sektori i përpunimit të ushqimit dhe i bujqësisë që eksporton në CEFTA është më i madh sesa nga industritë e tjera, vlera e ulët e eksporteve të tyre bën që produktet e përpunimit të ushqimit dhe sektorët e bujqësisë nuk janë në grupin e produkteve më të eksportuara nga Kosova.
- Një vëzhgim tjetër i rëndësishëm nga këto të dhëna është mungesa e shumëllojshmërisë së mallrave në eksport dhe përqendrimi kryesisht në 3-4 produkte. Kjo paraqet rrezik të lartë potencial nëse vendosen BJT të veçanta për këto produkte, çka do të sjellë një ndikim negativ në eksportet e Kosovës.
- Për të realizuar eksportet e tyre në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, kompanitë kosovare të cilat eksportojnë letra të përdorura për riciklim, janë të detyruara të eksportojnë përmes kompanive të treta në Maqedoninë e Veriut, gjë që bën të rriten kostot e tyre dhe i bënë ato më pak konkurruese.
- Eksportuesit e Kosovës, të cilët eksportojnë në CEFTA dhe në vendet e BE, përballen me më pak vështirësi për të eksportuar në BE sesa për të eksportuar në vendet e CEFTA-s. Disa prej të anketuarve eksportojnë produkte të njëjta në disa vende të BE dhe në vendet e CEFTA-s, por nuk përballen me

vështirësi për të eksportuar në BE, ndërsa eksportimi në CEFTA është i vështirë për ta edhe pse ata përdorin të njëjtat certifikata të cilësisë.

- Statusi politik i Kosovës dhe mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina krijon probleme serioze për eksport në këto dy vende, për shkak të mosnjohjes së dokumenteve të lëshuara nga autoritetet e Kosovës.
- Pavarësisht nga dispozitat e CEFTA-s, ekziston mungesa e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse të vendeve të ndryshme të CEFTA-s. Ekziston edhe mungesa e njohjes reciproke të certifikatave fitosanitare dhe veterinare.
- Eksportuesit e Kosovës po përballen me pengesa të brendshme gjatë përgatitjes për eksportimin e mallrave të tyre. Mungesa e stafit dhe procedurat burokratike të aplikuara nga disa Institucione Qeveritare po e vështirësojnë dhe po e bëjnë më të kushtueshëm eksportimin. Mungesa e stafit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në disa rajone, veçanërisht në Zyrën Rajonale të Ushqimit dhe Veterinës në Prizren, po krijon shumë vonesa dhe kosto për prodhuesit dhe eksportuesit vendorë për të marrë lejen e eksportit, e cila lëshohet nga kjo Agjenci. Rajoni i Prizrenit është i njohur për prodhimin e saj bujqësor dhe një numër i konsiderueshëm i prodhuesve dhe përpunuesve të ushqimit dhe pijeve janë përqendruar në këtë rajon.
- Eksportuesit e Kosovës të ushqimit dhe pijeve duhet të marrin lejen e eksportit fitosanitar dhe veterinar të lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, para eksportimit të mallrave të tyre. Për të marrë këtë leje, për çdo eksport duhet të dërgojnë mostrat e produkteve që planifikojnë të eksportojnë. Kërkesat për dërgimin e mostrave për çdo eksport kërkojnë shumë kohë, janë të kushtueshme dhe nuk bazohen në praktikat më të mira.
- Mjedisi i bizneseve në Kosovë ka nevojë për përmirësime të mëtejme dhe ende nuk ofron kushtet më të mira për zhvillim të biznesit. Kompanitë ankohen për mungesën e furnizimit të rregullt me energji elektrike dhe për mungesën e konkurrencës së drejtë të tregut dhe mbrojtjen nga importet e padrejta.
- Disa nga Administratat Doganore shpesh përdorin metodologji të ndryshme nga metoda e vlerës së transaksionit për vlerësimin e mallrave në procedurat e importit. Drejtoria Doganore e Shqipërisë zbaton të ashtuquajturën listën e çmimeve maksimale me të cilën ata nuk pranojnë ndonjë vlerë të faturës në import, nëse çmimet e produkteve në atë faturë janë më të ulëta se çmimet nga lista e tyre. Ata ngrisin çmimet për qëllime doganore dhe u kërkojnë kompanive të paguajnë taksa më të larta për importin.
- Eksportuesit e Kosovës nuk mund të marrin informacion në kohë në lidhje me kërkesat e ndryshme dhe rregulloret e importit në vende të ndryshme. 32% e të anketuarve thanë se nuk janë të informuar me kohë dhe nuk e dinë se ku duhet të marrin këtë informacion.

6 Rekomandimet

- Institucionet e Kosovës duhet të shtojnë kontaktet dypalëshe me homologët e tyre në vendet ku eksportuesit e Kosovës po përballen me pengesa në eksport, me qëllim të zgjidhjes së këtyre pengesave. Komiteti Nacional për Lehtësim të Tregtisë (KNLT) dhe bashkëpunimi me KNLT e tjera nga vendet fqinje mund të jenë një nga opsionet për zgjidhjen e këtyre pengesave.
- Bizneset duhet të inkurajohen që të raportojnë BJT-t dhe pengesat e tjera me të cilat përballen në eksport. Të dhënat e mbledhura tregojnë se 62% e të anketuarve nuk i kanë raportuar rastet e tyre tek autoritetet e vendit të destinacionit të eksporteve apo autoriteteve të Kosovës. Sipas shumicës së tyre, ata nuk i raportuan këto pengesa tek autoritetet, pasi nuk besonin se ata do të ndërmerrnin ndonjë veprim për t'i ndihmuar ata.
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet t'i raportojë këto raste në Sekretariatit e CEFTA-s dhe të kërkojë nga Sekretariati i CEFTA-s të ndihmojë në reduktimin / zgjidhjen e BJT-s ndërmjet anëtarëve të CEFTA-së.
- Qeveria e Kosovës duhet të rris bashkëpunimin me bizneset në Kosovë, për të kuptuar më mirë vështirësitë e tyre në të bërit biznes në Kosovë dhe eksportim.
- Edhe pse shumica e vështirësive dhe pengesave në eksport në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë janë të lidhura politikisht, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë çmos të gjejë një zgjidhje për të kapërcyer këto probleme.
- Qeveria duhet të punojë në përmirësimin e mjedisit të biznesit në Kosovë. Aty duhet të përfshihet infrastruktura ligjore dhe teknike.
- Disa agjenci qeveritare duhet të rrisin numrin e stafit të tyre, për t'u lehtësuar eksportuesve kosovarë marrjen e licencave dhe certifikatave të kërkuara. Gjetjet nga hulumtimi tregojnë se Agjencia Kosovare e Ushqimit dhe Veterinarisë është agjensi e cila për shkak të mungesës së stafit i prekë më së shumti eksportuesit e Kosovës.
- Qeveria përmes agjencive të saj si Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA) duhet të angazhohet më shumë të ndihmojnë bizneset e Kosovës për të pasur qasje më të lehtë në tregjet e huaja dhe t'i ndihmojnë ato në luftimin e perceptimit negativ në lidhje me cilësinë e produkteve të prodhuara në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës duhet të rrisë angazhimin e saj në ofrimin e informatave për bizneset e Kosovës për kërkesat e ndryshme dhe rregulloret e importit në vende të ndryshme.
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të përmirësojë procedurat e saj dhe të zvogëlojë kërkesat aktuale për eksport. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të fillojë aplikimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut në procedurat e tyre dhe të lëvizë nga aplikimi i procedurës uniforme për të gjitha kompanitë në procedurën moderne, e cila bazohet në profilizimin e riskut.

7 Shtojca 1 Pyetësori

Tema: Barrierat tregtare në eksport nga Kosova në vendet e CEFTA-s

1. Emri dhe adresa e kompanisë

_____.

2. Pozita juaj në kompani?

_____.

3. Qarkullimi juaj vjetor?

- Deri në 50,000 Euro
- Prej 50,000-100,000 Euro
- Prej 100,000-500,000 Euro
- Mbi 1,000,000 Euro

4. Cilës industri i takon kompania juaj?

_____.

4a. Cilat produkte i eksportoni ose eksportohen në vendet e CEFTA-s. Ju lutem cakeni emrin dhe numrin tuaj tarifor të produktit (numri 8-shifror)?

_____.

5. Cila është përqindja e eksportit nga qarkullimi juaj total?

_____.

6. Cila është përqindja e eksporteve në anëtarët e vendeve të CEFTA-s nga totali eksporteve?

_____.

7. Në cilin vend/e/anëtare të CEFTA-s ju eksportoni? Cili është tregu juaj kryesor për eksport?

_____.

8. Cila është përvoja eksportuese/importuese/tranzite në dhe nga vendet e CEFTA-s në aspektin e lehtësisë që produktet tuaja të hyjnë në treg dhe trajtimit të dhënë nga autoritetet e vendit të destinacionit?

	Shqipëria	Mali Zi	Maqedonia	B&H	Sërbia	Moldova
Jo mirë						
Mjaftueshëm						
Mirë						
Shumë mirë						
Shkëlqyeshëm						

9. A kini hasur në ndonjë vështirësi ose pengesa gjatë eksportit/importit/tranzitit në dhe nga vendet e CEFTA-s, për të cilën ju mendoni se nuk ishte pjesë e procedurës së zakonshme ose mendoni se ka pasur kërkesa të pajustificueshme dhe joproporcionale. Nëse përgjigja është po, a mund ta shpjegoni? Përshkruani në hollësi vështirësitë konkrete të hasura në vendet e destinacionit të eksporteve tuaja, vend pas vendi dhe që prekin produkte të veçanta nëse ai është rasti. Jepni sa më shumë hollësi në përgjigjet tuaja.

10. Cila mendoni se është arsyeja për veprim të tillë?

- Mungesa e procedurës legislative ose zbatimi opsional i rregulloreve
- Mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe teknike brenda autoriteteve në vendin e destinacionit
- Sjellja korruptive
- Të kufizohen importet nga Kosova
- Mungesa e marrëveshjeve reciproke ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe autoriteteve nga vendi i destinacionit
- Arsye tjera. Shpjegoni në hollësi.

10.a Sa mirë jeni të informuar me kërkesat e ndryshme dhe rregulloret e importit në vendet e ndryshme të CEFTA-s dhe modifikimet që bëhen në kërkesat dhe rregulloret? A mendoni se ekzistojnë vështirësi në marrjen e informatave të rëndësishme në kohë?

11. Cili ishte reagimi juaj në situatën e paraqitur në pyetjet 10 dhe 10.a?

- Jeni ankuar tek autoritetet në vendin e destinacionit
- Kini njoftuar autoritetet e Kosovës
- Kini ndaluar eksportimin

12. Çfarë mund të bëjnë autoritetet e Kosovës që t'iu ndihmojnë? A mundeni ju lutem të na jepni mendimin tuaj?

8 Shtojca 2 Lista e Kompanive që kanë marrë pjesë në hulumtim

No.	Name of the Company	Place
1	600143177 - STONECASTLE VINEYARDS & WINERY L.L.	Rahovec
2	600884755 - "FLEXOGRAF" SH.P.K.	Gjilan
3	600022339 - "EUROFOOD" SH.P.K.	Prizren
4	601044548 - "SUNNY HILLS" SH.P.K.	Rahovec
5	600033914 - "SATSTYRO" SH.P.K.	Prizren
6	601128988 - "HIT - FLORES" SH.P.K.	Dragash
7	600108741 - N.P.T. " KAMILA " SH.P.K.	Prizren
8	600277174 - N.P.T. „LIRI"	Prizren
9	600447983 - "PROTON CABLE" L.L.C.	Prizren
10	TREPHARM	Sllatine, Fushe Kosove
11	600106513 - N.T.P.ET-COM	Ferizaj
12	600087739 - "PLASTIKA" SH.P.K.	Fushe Kosove
13	600068937 - „RRONI FER" SH.P.K.	Gjakove
14	601651111 - " ROTO EKO " SH.P.K.	Prishtine
15	600141543 - „TREPÇA - NDËRMARRJE NË ADMINISTRIM	Mitrovice
16	600024096 - "REC KOS" SH.P.K.	Fushe Kosove
17	600171483 - "POFIX" SH.P.K.	Konjuh, Lipjan
18	600757069 - " GEMIX " SH.P.K.	Parku industrial Drenas
19	600911102 - " BIBITA " SH.P.K.	Vitomorice, Peje
20	600129341 - N.SH.P. „MITRO - PLAST"	Mitrovice
21	600510318 - NEWCO MINEX L.L.C.	Ferizaj
22	600047634 - „INTER STEEL" SH.P.K.	Prishtine
23	600119946 - „ADI" SH.P.K.	Lebane, Prishtine
24	600233093 - "NEWKO BALKAN" L.L.C.	Suhareke
25	600960878 - " LABERION " SH.P.K.	Podujeve
26	601182942 - " FRESH FRUIT - PR " SH.P.K.	Suhodolle, Graqanice
27	600792685 - " ENRAD " SH.P.K.	Gjilan
28	600005690 - "BESIANA - G" SH.P.K.	Prelez i Jerlive, rruga Prishtine- Ferizaj
29	600283080 - "BIRRA PEJA" SH.A.	Peje
30	600035928 - "IMK-INDU META E KOSOVËS"SH.P.K.	Ferizaj
31	600146717 - " M & SILLOSI " SH.P.K.	Xerxe, Rahovec
32	600002787 - FERPLAST	Ferizaj
33	600017736 - "FRUTEX" SH.P.K.	Suhareke
34	601531157 - " VENTIUS KOSOVO " L.L.C.	Gjakove
35	600052568 - "FLUIDI" SH.P.K.	Gjilan
36	600087466 - " SOLE KOSOVA " SH.P.K.	Fushe Kosove
37	600161658 - " PESTOVA " SH.P.K.	Pestove
38	KONSON	Milen, Gjakove
39	DANI COMPANY	Smallush, Lipjan
40	VI-PRINT	Parku i Biznesit Mitrovice
41	NARA	Rruga Prishtine-Shkup
42	OAZA	Prishtine
43	Argjendi-Pisha	Gjilan
44	MEKA shpk	Plave, Dragash
45	GRUDA	Vitomerice, Peje
46	Grate e Krushes	Krusha e Madhe, Rahovec
47	Haxhijaha	Rahovec
48	Vellezerit Borovci- BRICKOS	Kamenice
49	KORAL DAIRY	Fushe Kosove
50	"BODRUMI I VJETER"	Rahovec

9 Shtojca 3 Eksportet kryesore në vendet e CEFTA-së

Grupi i vendeve	Vendi	Nr	Artikujt	Vlera	Perqindja
1 Eksportet ne CEFTA	AL – Shqipëria	1	720449 - Të Tjera:	16,844,832.51	25.42%
		2	220300 - Në Shishe	8,828,735.76	13.32%
		3	730449 - Të Tjera:	6,616,185.49	9.98%
		4	760200 - Mbetje Dhe Kthime Alumini:	2,832,283.20	4.27%
		5	110100 - Prej Grurit Të Fortë	2,183,414.50	3.29%
		6	220210 - Ujrat, Përfshirë Ujrat Minerale Dhe Ujrat E Gazuar, Që Përmbajnë Sheqer Apo Lëndë Të Tjera Ëmbëlsuese Apo Aromatizuese Shtesë	1,829,238.01	2.76%
		7	391721 - Prej Polimereve Të Etilenit:	1,738,027.93	2.62%
		8	070190 - Të Tjera:	1,358,534.82	2.05%
		9	230230 - Prej Gruri:	992,282.40	1.50%
		10	220299 - Lengej Frutash	990,503.85	1.49%
		11	220421 - Në Konteniore Që Mbajne 2 Litra Apo Me Pak :	943,670.70	1.42%
		12	730690 - Të Tjera	894,038.69	1.35%
		13	681091 - Komponentët Strukturale Parafabrikate Për Inxhinjerinë Ndërtimore Apo Civil	832,737.60	1.26%
		14	481930 - Thasët Dhe Çantat, Që Kanë Një Bazë Prej Një Gjërësie 40 Cm Apo Më Shumë	728,022.07	1.10%
		15	392113 - Prej Poliuretaneve:	717,826.42	1.08%
		16	160100 - Sallam Dhe Produkte Të Ngjashme,Prej Mishi, Prej Të Brendshmeve Të Mishit Apo Prej Gjakut;Përgatitjet Ushqimore Me Bazë Të Këtyre Produkteve:	699,514.73	1.06%
		17	730439 - Të Tjera:	682,155.15	1.03%
		18	440394 - Prej Ahut (Fagus Spp), Te Tjera	503,617.50	0.76%
		19	090121 - E Pa Dekafeinizuar	492,634.80	0.74%
		20	940429 - Prej Materialelesh Të Tjera :	443,356.25	0.67%
		21	Kodet tj.	15,122,050.31	22.82%
	AL - Shqipëria - Totali			66,273,662.69	100.00%
	BA – Bosnja dhe Hercegovina	1	410150 - Sholle Dhe Lëkurë Të Papërpunuar Të Plota, Të Një Peshe Më Tepër Se 16 Kg:	1,593,834.41	20.60%
		2	730690 - Të Tjera	1,259,986.65	16.29%
		3	410120 - Lëkurët E Gjedheve Të Tëra, Të Një Peshe Për Një Lëkurë Jo Më Tepër Se 8 Kg Kur Thjesht Thahet, 10 Kg Kur Thahet Dhe Kripet, Apo 16 Kg Kur Është E Freskët, E Kriposur E Njomë Apo E Ruajtur Ndryshe :	860,000.15	11.12%
		4	730449 - Të Tjera:	595,885.31	7.70%

	5	220210 - Ujrat, Përfshirë Ujrat Minerale Dhe Ujrat E Gazuar, Që Përbajnë Sheqer Apo Lëndë Të Tjera Ëmbëlsuese Apo Aromatizuese Shtesë	448,643.66	5.80%
	6	401012 - Të Përforcuar Vetëm Me Materiale Tekstile	317,473.44	4.10%
	7	392010 - Prej Polimereve Të Etilenit:	283,170.94	3.66%
	8	470730 - Prej Letrës Apo Kartonit Të Bërë Kryesisht Prej Brumit Mekanik (Psh, Gazeta, Revistat Dhe Materiale Të Ngjashme Të Shtypura):	223,597.40	2.89%
	9	570292 - Prej Materialeve Tekstile Të Bëra Nga Njerëzit:	218,424.33	2.82%
	10	482340 - Rolete, Fletat Dhe Disqet, Të Shtypura Për Aparatet Vetë Regjistruese	199,507.30	2.58%
	11	190590 - Të Tjera:	191,179.52	2.47%
	12	732211 - Prej Gize Të Dërdhur	142,058.05	1.84%
	13	220421 - Në Konteniore Që Mbajnë 2 Litra Apo Me Pak :	133,870.08	1.73%
	14	081040 - Legjithje(Boronic E Kuqe), Rrush Mali(Boronicë) Dhe Fruta Të Tjera Të Llojit Vaccinium:	125,493.20	1.62%
	15	220299 - Lengje Frutash	100,240.00	1.30%
	16	640299 - Të Tjera:	93,115.20	1.20%
	17	392111 - Prej Polimereve Të Stirenit	80,977.31	1.05%
	18	081190 - Të Tjera:	66,315.00	0.86%
	19	960390 - Të Tjera:	52,118.66	0.67%
	20	081020 - Manaferra Të Buta, Manaferra Të Egra, Mana Dhe Rrush Logan:	49,646.00	0.64%
	21	Kodet tj.	700,089.08	9.05%
BA - Bosnja dhe Herzegovina - Totali			7,735,625.69	100.00%
MD - Moldova	1	980500 - Mallra Te Perziera (Laramani)	4,976.00	75.67%
	2	630533 - Të Tjera, Prej Shirritash Polietileni Apo Polipropileni Apo Prej Të Ngjashmeve Të Tyre:	1,600.00	24.33%
MD - Moldova - Totali			6,576.00	100.00%
ME – Mali i Zi	1	260700 - Xeherore Dhe Koncentrate Plumbi	7,398,250.66	39.93%
	2	740400 - Mbetjet Dhe Kthimet E Bakrit:	2,412,042.35	13.02%
	3	760200 - Mbetje Dhe Kthime Alumini:	1,516,451.49	8.18%
	4	854140 - Paisjet Gjysëmpërçuese Të Ndjeshme Ndaj Dritës, Përfshi Pilat Fotovoltaike Nëse Janë Apo Jo Të Montuara Në Module Në Panele; Diodat Emetuese Të Dritës:	532,952.00	2.88%
	5	220210 - Ujrat, Përfshirë Ujrat Minerale Dhe Ujrat E Gazuar, Që Përbajnë Sheqer Apo Lëndë Të Tjera Ëmbëlsuese Apo Aromatizuese Shtesë	511,223.65	2.76%
	6	261800 - Zgjyra Të Granuluara (Rërë Zgjyre) Të Dalë Nga Përpunimi I Hekurit Dhe Çelikut	419,889.60	2.27%
	7	392030 - Prej Polimereve Të Stirenit	330,554.60	1.78%

	8	730449 - Të Tjera:	300,361.22	1.62%
	9	321490 - Të Tjera	295,160.70	1.59%
	10	720449 - Të Tjera:	205,048.59	1.11%
	11	401012 - Të Përforcuar Vetëm Me Materiale Tekstile	187,544.96	1.01%
	12	730661 - Me Prerje Tërthore Katrori Apo Katërkëndëshi :	174,140.40	0.94%
	13	470730 - Prej Letrës Apo Kartonit Të Bërë Kryesisht Prej Brumit Mekanik (Psh, Gazeta, Revistat Dhe Materiale Të Ngjashme Të Shtypura):	162,668.63	0.88%
	14	790200 - Mbetje Dhe Kthime Zinku	155,459.94	0.84%
	15	732690 - Të Tjera:	154,469.51	0.83%
	16	611780 - Plotësues Të Tjerë :	130,058.11	0.70%
	17	720429 - Të Tjera	110,961.57	0.60%
	18	190590 - Të Tjera:	97,404.07	0.53%
	19	392113 - Prej Poliuretaneve:	94,341.73	0.51%
	20	392111 - Prej Polimereve Të Stirenit	91,687.37	0.49%
	21	Kodet tj.	3,246,688.36	17.52%
	ME – Mali i Zi - Totali		18,527,359.51	100.00%
MK – IRJ e Maqedonisë	1	720449 - Të Tjera:	6,995,882.97	16.72%
	2	740400 - Mbetjet Dhe Kthimet E Bakrit:	6,325,028.18	15.12%
	3	220210 - Ujrat, Përfshirë Ujrat Minerale Dhe Ujrat E Gazuar, Që Përmbajnë Sheqer Apo Lëndë Të Tjera Ėmbëlsuese Apo Aromatizuese Shtesë	2,805,052.25	6.70%
	4	730690 - Të Tjera	2,646,671.28	6.33%
	5	392111 - Prej Polimereve Të Stirenit	1,813,516.57	4.33%
	6	730661 - Me Prerje Tërthore Katrori Apo Katërkëndëshi :	1,456,604.95	3.48%
	7	090121 - E Pa Dekafeinizuar	1,375,648.00	3.29%
	8	470730 - Prej Letrës Apo Kartonit Të Bërë Kryesisht Prej Brumit Mekanik (Psh, Gazeta, Revistat Dhe Materiale Të Ngjashme Të Shtypura):	1,355,572.61	3.24%
	9	854810 - Mbetje Dhe Mbeturina Të Qelizave Primare, Baterive Primare Dhe Akumulatorëve Primare; Qelizat Primare Të Harxhuara, Bateritë Primare Të Harxhuara Dhe Akumulatorët Elektrikë Të Harxhuar:	1,150,927.87	2.75%
	10	760200 - Mbetje Dhe Kthime Alumini:	1,019,544.12	2.44%
	11	271311 - E Pa Kalcinuar	698,417.49	1.67%
	12	470790 - Të Tjera, Përfshirë Mbetjet Dhe Kthimet E Pa Seleksionuara:	522,709.93	1.25%
	13	392010 - Prej Polimereve Të Etilenit:	503,585.07	1.20%
	14	392119 - Prej Plastikave Të Tjera	479,355.99	1.15%
	15	391590 - Prej Plastikave Të Tjera:	455,582.33	1.09%
	16	730890 - Të Tjera:	442,915.21	1.06%
	17	220299 - Lengje Frutash	409,594.37	0.98%

	18	681011 - Blloqet Dhe Tullat E Ndërtimit:	394,314.29	0.94%	
	19	731420 - Grilla, Rrjeta Dhe Gardhe, Të Salduara Tek Ndërprerjet, Prej Teli Me Një Maksimum Të Dimensionit Kryq Seksional Prej 3 Mm Apo Më Shumë Dhe Që Kanë Një Masë Të Vrimës Së Rrjetës Prej 100 Cm2 Apo Me Shume:	340,424.28	0.81%	
	20	200520 - Patate:	318,323.64	0.76%	
	21	Kodet tj.	10,327,383.56	24.68%	
	MK – IRJ e Maqedonisë - Totali		41,837,054.96	100.00%	
	XS – Sërbia	1	271600 - Energji Elektrike	8,783,676.26	27.29%
		2	730661 - Me Prerje Tërthore Katrori Apo Katërkëndëshi :	3,047,125.80	9.47%
		3	730690 - Të Tjera	2,409,594.49	7.49%
		4	410120 - Lëkurët E Gjedheve Të Tëra, Të Një Peshe Për Një Lëkurë Jo Më Tepër Se 8 Kg Kur Thjesht Thahet, 10 Kg Kur Thahet Dhe Kripet, Apo 16 Kg Kur Është E Freskët, E Kriposur E Njomë Apo E Ruajtur Ndryshe :	1,449,416.44	4.50%
		5	220429 - Të Tjera:	1,374,312.50	4.27%
		6	732211 - Prej Gize Të Dërdhur	1,261,550.52	3.92%
		7	081020 - Manaferra Të Buta, Manaferra Të Egra,Mana Dhe Rrush Logan:	1,115,571.24	3.47%
		8	392113 - Prej Poliuretaneve:	758,686.71	2.36%
		9	392310 - Kutite, Kasat, Sendyqet Dhe Artikuj Të Ngjashëm	653,972.65	2.03%
		10	441520 - Palete, Kutite E Paletave Dhe Panele Të Tjera Për Ngarkim; Mbështjellëset E Paletave :	559,827.28	1.74%
		11	200799 - Të Tjera:	552,700.85	1.72%
		12	081120 - Manaferra Të Buta, Manaferra Të Egra,Mana,Rrush Logan,Rrush Frengu I Zi,I Bardhë Apo I Kuq Dhe Rrush I Egër:	493,332.34	1.53%
		13	220421 - Në Konteniëre Që Mbajne 2 Litra Apo Me Pak :	440,509.40	1.37%
		14	392111 - Prej Polimereve Të Stirenit	433,285.01	1.35%
		15	392010 - Prej Polimereve Të Etilenit:	428,500.74	1.33%
		16	081190 - Të Tjera:	427,119.15	1.33%
17		730630 - Të Tjera, Të Salduara, Të Një Seksioni Kryq Seksional Rrethor, Prej Gize Apo Çelik Jo Të Lidhur:	411,195.71	1.28%	
18		401012 - Të Përforcuar Vetëm Me Materiale Tekstile	385,498.07	1.20%	
19		271311 - E Pa Kalcinuar	305,740.68	0.95%	
20		780420 - Pluhura Dhe Fetëza	282,196.74	0.88%	
21		Kodet tj.	6,618,197.94	20.56%	
XS - Serbia - Totali		32,192,010.52	100.00%		
1 Eksportet në CEFTA - Totali		166,572,289.36	251.34%		

KLASIFIKIMI I Barrierave Jo-Tarifore		
	Masat Sanitare dhe Fitosanitare	
A1 Ndalesat/kufizimet e importeve për SFS	A11 Ndalesat e përkohshme gjeografike për arsye SFS	
	A12 Kufizimet gjeografike për pranueshmërinë	
	A13 Qasja në sistem	
	A14 Autorizimi i veçantë për arsye të SFS	
	A15 Kërkesat e regjistrimit	
	A19 Ndalesat/kufizimet e importeve për arsye të SFS, të paspecifikuara dikund tjetër (p.d.t.)	
A2 Kufizimet e tolerancës për mbetjet dhe përdorim të kufizuar të substansave	A21 Kufijtë e tolerancës për mbetjet ose kontaminimin nga substanca (jo-mikro-biologjike) të caktuara	
	A22 përdorimi i kufizuar i substancave të caktuara në ushqime dhe foragjeri dhe materialet e tyre kontaktuese	
A3 Kërkesat e etiketimit, shënimit dhe paketimit	A31 Kërkesat e etiketimit	
	A32 Kërkesat e shënimit	
	A33 Kërkesat e paketimit	
A4 Kërkesat higjienike	A41 Kriteret mikro-biologjike të produktit final	
	A42 Praktikat higjienike gjatë prodhimit	
	A49 Kërkesat higjienike	
A5 Trajtimi për asgjësim të dëmtuesve të bimëve dhe kafshëve dhe organizmave që shkaktojnë sëmundje në produktin final (p.sh. trajtimi pas-korrjes)	A51 Trajtimi i ftohtë/i ngrohtë	
	A52 Rrezatimi	
	A53 Tymosja	
	A59 Trajtimi për eliminim të dëmtuesve të bimëve dhe kafshëve dhe organizmave që shkaktojnë sëmundje në produktin final, p.d.t.	
A6 Kërkesat tjera për proceset e prodhimit dhe pas-prodhimit	A61 Proceset në kultivimin e bimëve	
	A62 Proceset e rritjes apo kapjes së kafshëve	
	A63 Përpunimi i ushqimit dhe foragjerisë	
	A64 Kushtet e ruajtjes dhe transportit	
	A69 Kërkesat tjera për proceset e prodhimit ose pas-prodhimit, p.d.t.	

A8 Vlerësimi i konformitetit lidhur me SFS	A81 Kërkesa për regjistrimit të produktit	
	A82 Kërkesat e testimit	
	A83 Kërkesa e certifikimit	
	A84 Kërkesa e inspektimit	
	A85 Kërkesat e gjurmueshmërisë	A851 Origjina e materialeve dhe pjesëve
		A852 Historia e përpunimit
		A853 Shpërndarja dhe lokacioni i produkteve pas dorëzimit
		A859 Kërkesa e gjurmueshmërisë, p.d.t.
	A86 Kërkesa për karantinë	
	A89 Vlerësimi i konformitetit lidhur me SFS, p.d.t.	
	A9 Masat SFS, p.d.t.	
	Barrierat Teknike në Tregti	
B1 Ndalesat/kufizimet e importeve për objektivat e përcaktuar në marrëveshjet e BTT	B11 Ndalesa për arsye të BTT	
	B14 Kërkesa e autorizimit për arsye të BTT	
	B15 Kërkesa e regjistrimit për importuesit për arsye të BTT	
	B19 Ndalesat/kufizimet e importeve për objektivat e përcaktuar në marrëveshjen e BTT, p.d.t.	
B2 Kufijtë e tolerances për mbetjet dhe përdorimin e kufizuar të substancave	B21 Kufijtë e tolerancës për mbetjet e ose kontaminimin nga substancat e caktuara	
	B22 Përdorimi i kufizuar i substancave të caktuara	
B3 Kërkesat e etiketimit, shënimit dhe paketimit	B31 Kërkesat e etiketimit	
	B32 Kërkesat e shënimit	
	B33 Kërkesat e paketimit	
B4 Kërkesat e prodhimit dhe pas-prodhimit	B41 Rregulloret e BTT për proceset e prodhimit	
	B42 Rregulloret e BTT për transport dhe ruajtje	
	B49 Kërkesat e prodhimit dhe pas-prodhimit, p.d.t.	
B6 Kërkesat e identitetit të prodhimit		
B7 Kërkesat e cilësisë dhe performancës së produktit		

B8 Vlerësimi i konformitetit lidhur me BTT	B81 Kërkesat për regjistrim të produktit	
	B82 Kërkesat e testimit	
	B83 Kërkesat e certifikimit	
	B84 Kërkesat e inspektimit	
	B85 Kërkesat për informata të gjurmueshmërisë	B851 Origjina e materialeve dhe pjesëve
		B852 Historiku i përpunimit
		B853 Shpërndarja dhe lokacioni i produkteve dhe orëzimi
		B859 Kërkesa e gjurmueshmërisë, p.d.t.
	B89 Vlerësimi i konformitetit lidhur me BTT, p.d.t.	
B9 Masat e BTT, p.d.t.		
C1 Inspektimi para-dërgesës		
C2 Kërkesa për dërgesë të drejpërdrejtë		
C3 Kërkesa për të kaluar në port të specifikuar doganor		
C4 Kërkesat për monitorim dhe mbikëqyrje dhe masat tjera për licencim automatik		
C5 Formalitetet tjera, p.d.t.		
D1 Masat antidamping	D11 Hetimi anti-damping	
	D12 Taksa anti-damping	
	D13 Caktimi i çmimit	
D2 Masat kundër-balancuese	D21 Hetimi kundër-balancues	
	D22 Taksa kundër-balancuese	
	D23 Caktimi	
	D31 Masa e përgjithshme (multilaterale)	D311 Hetimi i masave mbrojtëse
		D312 Taksa mbrojtëse
		D313 Kufizimi i mbrojtjes sasiore
		D314 Masat mbrojtëse, formë tjetër

D3 Masat mbrojtëse	D32 Masa e veçantë mbrojtëse bujqësore	D321 Masa e veçantë mbrojtëse bujqësore që bazohet në vëllim
		D322 Masa e veçantë mbrojtëse bujqësore që bazohet në çmim
	D39 Masa mbrojtëse, p.d.t.	
E1Procedurat për licencim jo-automatik të importeve përveç autorizimit për arsye të SFS ose BTT	E11 Licencimi për arsye ekonomike	E111 Procedura e licencimit pa kritere specifike ex ante
		E112 Licencimi për përdorim të veçantë
		E113 Licencimi me prodhim vendor
		E119 Licencimi për arsye politike, p.d.t.
	E12 Licencimi për arsye jo-ekonomike	E121 Licencimi për arsye religjioze, morale ose kulturore
		E122 Licencimi për arsye politike
		E129 Licencimi për arsye jo-ekonomike, p.d.t.
E2Kuotat	E21 E përhershme	E211 Alokimi global
		E212 Alokimi i vendeve
	E22 Kuotat sezonale	E221 Alokimi global
		E222 Alokimi i vendeve
	E23 E përhershme	E231 Alokimi global
		E232 Alokimi i vendeve
E3 Ndalesat përveç SFS dhe BTT	E31 Ndalesa për arsye ekonomike	E311 Ndalesa e plotë (ndalimi i importit)
		E312 Ndalesa sezonale
		E313 Ndalesa e përkohshme, përfshirë pezullimin e lëshimit të licencave
		E314 Ndalesa e importimit në masë
		E315 Ndalesa e produkteve që cenojnë patentat ose të drejtat tjera intelektuale
		E316 Ndalesat e mallrave të përdorura, riparuar ose përpunuara
		E319 Ndalesa për arsye ekonomike, p.d.t.

	E32 Ndalesa për arsye joekonomike	E321 Ndalesa për arsye fetare, morale ose kulturore
		E322 Ndalesa për arsye politikes (embargo)
		E329 Ndalesa për arsye joekonomike, p.d.t.
E5 Marrëveshjet mbi kufizimin e eksportit	E51 Marrëveshjet mbi kufizimet vullnetare të eksportit (KVE-t)	E511 Marrëveshja mbi kuotat
		E512 Marrëveshja mbi këshillimin
		E513 Marrëveshja mbi bashkëpunimin administrativ
E6 Kuotat e normës tarifore (KNT)	E59 Marrëveshjet mbi kufizimin e eksportit, p.d.t.	
E6 Kuotat e normës tarifore (KNT)	E61 KNT-t të lidhura me OBT, janë përfshirë në planet e OBT-s (koncesionet dhe zotimet sipas negociatave të OBT-s)	E611 Alokimi global
		E612 Alokimi i vendeve
		E621 Alokimi global
E9 Masat për kontrollin e cilësisë, p.d.t.	E62 KNT-t tjera të përfshira në marrëveshjet tjera tregtare	E622 Alokimi i vendeve
F1 Masat administrative që prekin vlerën doganore	F11 Çmimet minimale të importit	
F2 Kufizimet vullnetare të çmimeve të eksportit (KVÇE-t)	F12 Çmimet referuese	
F3 Pagesat e ndryshueshme	F19 Masat tjera administrative që prekin vlerën doganore, p.d.t.	
F4 Mbipagesat doganore	F31 Tarifat e ndryshueshme	
F5 Taksat sezonale	F32 Komponentet e ndryshueshme	
F6 Taksat dhe pagesat shtesë të vendosura për shërbimet e ofruara nga qeveria	F39 Pagesat e ndryshueshme, p.d.t.	
F6 Taksat dhe pagesat shtesë të vendosura për shërbimet e ofruara nga qeveria	F61 Tarifat e inspektimit, përpunimit dhe shërbimit	
F6 Taksat dhe pagesat shtesë të vendosura për shërbimet e ofruara nga qeveria	F62 Mallrat – tarifat e trajtimi ose ruajtjes	
F6 Taksat dhe pagesat shtesë të vendosura për shërbimet e ofruara nga qeveria	F63 Tatimi në transaksionet në valutë të huaj	
F6 Taksat dhe pagesat shtesë të vendosura për shërbimet e ofruara nga qeveria	F64 Taksa e vulës	

	F65 Tarifa për licence të importit	
	F66 Tarifa për faturim konzular	
	F67 Tatimi statistikor	
	F68 Tatimi për objektet e transportit	
	F69 Pagesat shitesë, p.d.t.	
F7 Taksat dhe pagesat e brendshme të vendosura në importe	F71 Tatimi në konsum	
	F72 Tatimi në akcizë	
	F73 Tatimi dhe pagesat për kategoritë e produkteve të ndjeshme	
	F79 Taksat dhe pagesat e brendshme të vendosura në importe, p.d.t.	
F8 Vlerësimet e ulura doganore		
F9 Masat për kontroll të çmimeve, p.d.t.		
G1 Kërkesat për parapagim	G11 Depozita parapake e importit	
	G12 Kërkesa për marzhë në para të gatshme	
	G13 Pagesa paraprake e detyrimeve doganore	
	G14 Depozitat e rimbursueshme për kategoritë e produkteve të ndjeshme	
	G19 Kërkesat për parapagim, p.d.t.	
G2 Normat e shumta këmbimore		
G3 Rregullorja për alokim zyrtar të këmbimit valutor	G31 Ndalesa e alokimit të këmbimit valutor	
	G32 Autorizimi bankar	
	G33 Autorizimi i lidhur me këmbimin jozyrtar valutor	G331 Këmbimi i jashtëm valutor
		G332 Këmbimi valutor personal i importuesve
		G339 Licenca lidhur me këmbimit jozyrtar valutor, p.d.t.
	G39 Rregullorja për alokim zyrtar të këmbimit valutor, p.d.t.	
G4 Rregulloret mbi afatin e pagesës për importe		
G9 Masat financiare, p.d.t.		
H1 Ndërmarrjet shtetërore tregtare, për importim: kanalet tjera selektive të importit	H11 Ndërmarrjet shtetërore tregtare, për importim	
	H19 Kanalet tjera selective të importit, p.d.t.	

H2 Shfrytëzimi detyrimor i shërbimeve nacionale	H21 Sigurimi detyrimor nacional	
	H22 Transporti detyrimor nacional	
	H29 Shërbimi detyrimor nacional, p.d.t.	
H9 Masat që ndikojnë në konkurrencë, p.d.t.		
I1 Masat për përmbajtje lokale		
I2 Masat për balancim tregtar		
I9 Masat për investim në tregt, p.d.t.		
J1 Kufizimi gjeografik		
J2 Kufizimi për rishitësit		
P1 Licencat e eksportit, -kuota-, -ndalesa dhe kufizimet tjera sasiore	P11 Ndalimi i eksportit	
	P12 Kuotat e eksportit	
	P13 Kërkesat për licencim ose leje për eksport	
	P14 Kërkesat për regjistrim të eksportit	
	P19 Kufizimet sasiore në eksport, p.d.t.	
P2 Ndërmarrjet shtetërore tregtare për eksportim; kanalet tjera selektive të eksportit	P21 Ndërmarrjet shtetërore tregtare, për eksportim	
	P29 Kanalet tjera selektive të eksportit, p.d.t.	
P3 Masat për kontrolle të çmimit të eksportit		
P4 Masat për ri-eksport		
P5 Taksat dhe pagesat për eksport		
P6 Masat teknike për eksport	P61 Kërkesa për inspektim	
	P62 Certifikata të cilën e kërkon vendi i eksportimit	
	P69 Masat teknike për eksport, p.d.t.	

P7 Subvencionet për eksport		
P8 Kreditë për eksport		
P9 Masat për eksport, p.d.t..		